



TË DREJTAT PRONËSORE DHE TRASHËGIMORE TË GRAVE

Hulumtimi është bërë në kuadër të Projektit “Ndihma Juridike, Litigimi për të Drejtat Pronësore dhe të Trashëgimisë për Gratë, si dhe Ngritja e Kapaciteteve të Juristëve të Rinj”

Prof. Asst. Dr. Jorida Xhafaj

Eksperte Ligjore në Projekt

Anton Nrecaj

Menaxher i projekti dhe Këshilltar ligjor në CLARD

Prishtinë, Mars 2017

Ky hulumtim ka ndezur një shkëndijë shprese për njohjen dhe respektimin e të drejtave pronësore e trashëgimore të grave, duke vazhduar punën për të parë flakën e vërtetë në zbatimin e këtyre të drejtave

Hulumtimi u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID.

Përmbajtja është përgjegjësi e organizatës CLARD dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e USAID apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Projekti “Ndiurma Juridike, Litigimi për të Drejtat Pronësore dhe të Trashëgimisë për Gratë, si dhe Ngritja e Kapaciteteve të Juristëve të Rinj” implementohet nga CLARD, përmes Programit Angazhimi për Barazi – E4E, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID dhe realizuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC.



PËRMBAJTJA

HYRJE	4
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	7
QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT	8
1. NORMAT NDËRKOMBËTARE DHE KUADRI LIGJOR KOMBËTAR	9
2. TË DREJTAT PRONËSORE NË KONTEKSTIN E TË DREJTËS ZAKONORE	23
3. ZHVILLIMI HISTORIK DHE SFIDAT E TË DREJTAVE PRONËSORE TË GRAVE	27
4. NJËANSHMËRIA MBI BAZË GJINORE DHE DOMINIMI NË PRONË	32
4.1 EDUKIMI DHE NGRITJA E NIVELIT TË INFORMIMIT MBI TË DREJTAT PRONËSORE DHE PËRFITIMIN E TYRE	35
4.2 PËRMIRËSIMI I KLIMËS SHOQËRORE DHE INSTITUCIONALE PËR MBËSHTETJEN E GRAVE NË KËTË SFIDË	38
4.3 REALIZIMI I GARANCIVE PROCEDURIALE	42
PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET	44
PUNIMET E CITUARA	48

HYRJE

Të parët tanë u rritën dhe edukuan me moralin se pasuria dhe prona janë burimi i jetesës, ruajtja e personalitetit të secilit dhe mënyra e pavarësimit në jetë. Devijimi prej këtij morali, duke u kushtëzuar prej përkatësisë gjinore dhe statusit të femrës në familjet tona përbën një fatkeqësi.

Posedimi i një pasurie të luajjtëshme apo të paluajjtëshme i jep çdokujt mundësinë të krijojë kapital financiar e njëherazi pushtetin e vendimarrjes së pavaruar në familje dhe shoqëri. Me respektimin e të drejtës së pronës të grave mund të krijohet shtegu, prej pronës drejt pjesmarrjes aktive të tyre në jetën ekonomike në vend.

Sot, garantimi i të drejtave pronësore dhe trashëgimore të grave dhe vajzave në Kosovë ngelet një çështje për t'u zgjidhur!

E drejta në pronë është një e drejtë themelore që garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për Trashëgiminë i Kosovës, Ligji për Procedurën Jo Kontestimore dhe Ligji për Procedurën Kontestimore. Megjithë kuadrin e plotë ligjor, hapësirat e krijuara nga ligji lenë mundësi të influencimit të rregullave të traditës patriakale në vend. Shfrytëzimi dhe e drejta për të zotëruar pronën mbetet faktor i rëndësishëm për fuqizimin ekonomik të gruas, ndaj reagimi dhe marrja e masave kundër këtij fenomeni përbën edhe një prioritet në rrugën e zhvillimit në përputhje me standartet europiane e më gjerë.

Sistemet dhe të drejtat e pronësisë ndryshojnë nga një shoqëri në tjetrën duke u ndikuar nga faktorë kulturorë, racorë, politikë dhe juridikë. Mungesa e kontrollit mbi burimet e së drejtës që ekzistojnë, për të qenë titullarë i një prone, i vendos gratë në një pozicion të disfavorshëm të të drejtave pronësore dhe nivel të reduktuar të qasjes në mundësi ekonomike. Të drejtat pronësore mbi tokën, shpërndarja e pasurisë, si dhe zhvillimi i tregut, kanë evoluar si parakushte të rritjes ekonomike dhe kanë ndikuar në uljen e varfërisë në etapa të ndryshme të zhvillimit shoqëror.

Globalizimi dhe industrializimi, kanë sjellë rritjen e numrit të grave të angazhuara në sektorë të ndryshëm ekonomik dhe pavarësisht kësaj gratë zotërojnë vetëm rreth 1-2 perqind të të gjithë tokës të regjistruar në botë dhe janë në mënyrë të vazhdueshme të mohuara nga e drejta për të trashëguar pasuri. Për më tepër, mohimi i të drejtave pronësore të grave ka qenë gjithnjë i

lidhur me probleme të zhvillimit, me të cilat përballen vendet në të gjithë globin, duke përfshirë kryesisht nivelin arsimor¹dhe presionin e normave zakonore.

Rëndësia e garantimit të pronës dhe të drejtave trashëgimore të grave është njohur gjithnjë e në rritje, gjatë dekadave të fundit, nga një sërë aktesh ligjore në nivel kombëtar, si dhe prej instrumenteve ligjore ndërkombëtare në kuadër të zhvillimit të parimit të barazisë midis grave dhe burrave (p.sh., në Konventat Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe Konventa mbi të Drejtat Civile dhe Politike. Progresi në normimin e nevojshëm të të drejtave pronësore dhe garantimi i tyre u shoqërua njëherazi me zhvillim në përshtatjen e sistemit të masave të përshtatëshme ligjore dhe institucionale, si edhe qëndrimet tradicionale në shoqëri.

Me gjithë përpjekjet e strukturave shtetërore, përfaqësive diplomatike në Kosovë, organizmat ndërkombëtarë dhe shoqërisë civile, shtetaset e Kosovës enden në kalvarin e gjatë të pengesave për gëzuar pronë. Dinamika e zhvillimeve në drejtim të fitimit dhe ushtrimit real të kësaj të drejte është pozitive, përse kohë janë konstatuar problematikat dhe propozohen vazhdimisht masa, të cilat ti përshaten mentalitetit dhe formimit të popullatës. Në këtë pikë kemi marr përsipër të përkufizojmë pengesat e mbetura ende për të ndryshuar:

- Ekzistenca e një korpusi ligjor përballë sistemeve të zbatimit të klasifikuar si joadekuate;
- Mungesa e vetëdijes se ekzistojnë ligjet dhe të kuptuarit të pamjaftueshëm të opsioneve për zgjidhjen ligjore dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- Përhapja e qëndrimeve tradicionale dhe praktikave, shumë prej të cilave drejtpërdrejtë kundërshtojnë ligjet statutoare dhe të drejtat civile e vendosura; dhe
- Vendimet për rastet pronësore, që posaçërisht demonstrojnë një trend të arsytetimeve të mangëta dhe peshimit të gabuar të provave. Gjykatat shpesh i japin peshë më të madhe dëshmisë së palëve të interesuara sesa provave të dokumentuara që ligji i definon si mundësisht të rregullta, duke rezultuar me procese tejet të zgjatura në kohë, shpenzime, mekanizma proceduralë të diskutueshëm dhe mbi të gjitha uljen e besimit të grave se do të gëzojnë të drejtat e tyre. Veç kësaj, në shumë raste të trajtuara nga Klinika për ndihmë juridike falas, Gjykatat nuk i referohen parimeve kushtetuese dhe dispozitave ligjore të rastit, ku edhe të mbështesin vendimet e tyre.

¹ http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PNADA958.pdf

Hulumtimi është strukturuar në tre pjesë. Pjesa e parë trajton kuadrin ligjor në vend dhe zbrazëtsitë të cilat lejojnë apo lehtësojnë abuzimet me të drejtat pronësore e kryesisht ato trashëgimore të grave. Evidentimi i normave materiale dhe procedurale, të cilat kanë krijuar, në zhvillimin historik të vendit si një shtet i pavarur, një sistem që favorizon mbizotërimin e normave zakonore mbi ato ligjore.

Pjesa e dytë merr përsipër të analizojë modele të garantimit të të drejtave drejtave pronësore të grave, duke nxjerr në pah mekanizmat e zbatuar për të arritur eficensën e nevojshme dhe rritjen e përqindjes së grave që zotërojnë pasuri. Është përzgjedhur Kroacia dhe Shqipëria si vende me histori të ngjashme në zhvillimin e të drejtave pronësore dhe mekanizma me zbatueshmëri edhe në Kosovë për mbrojtjen e plotë të grave në këtë drejtim. Gjithashtu, vlen të theksohet se Shqipëria ka ngritur sistemin e saj të të drejtave pronësore të grave mbi të njëtin rrafsh kulturor dhe zakonor. Ndërkohë Kroacia megjithë ngjashmëritë mbi të kaluarën e përbashkët të organizimit shoqëror e shtetëror gjatë periudhës jugosllave, vlen të analizohet për trendin dinamik të zhvillimit të saj dhe standarteve juridike të garantuara si vend anëtarë i Bashkimit Europian.

Së treti, një pjesë esenciale e punimit janë analizimi i faktorëve problematikë të grupuar dhe mekanizmave që u përgjigjen si zgjidhje këtyre faktorëve. Ndër rastet praktike të trajtuara në veprimtarinë e Klinikës juridike për ndihmë falas nga CLARD dhe klinikës ligjore pranë Kolegjit ILIRIA, është përzgjedhur njëri prej tyre për të ilustruar edhe garancitë procedurale në sistemin gjyqësor, të cilat mund të përbëjnë një pikë kthese në rritjen e numrit të grave që pretendojnë të drejtat pronësore në Kosovë.

Studimi përfundon me rekomandime, të cilat synojnë të parashtrojnë mënyrën se si të tejkalohen problemet e identifikuar apo përmirësohen proceset e njohjes së të drejtave pronësore të grave.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Për studimin e gjithanshëm dhe të mirëfilltë të gjendjes së mbrojtjes të të drejtave pronësore dhe kryesisht ato trashëgimore, janë përdorur metodat e analizës teorike, empirike dhe krahasuese.

Metodologjia primare e përdorur në këtë hulumtim ishte një rishikim i seleksionuar i legjislacionit në fuqi dhe një analizë cilësore e impaktit të dispozitave ligjore në marrëdhëniet pronësore, trashëgimore dhe procesuale.

Fillimisht janë analizuar aktet ligjore nën dritën e akteve ndërkombëtarë dhe raportet e deritanishme të publikuara në Kosovë me fokus përmirësimin e regjimit të të drejtave pronësore në Kosovë, forcimin e sundimit të së drejtës, dhe rritjen e zhvillimit ekonomik në vend. Në përfundim të kësaj analize është dal me përfundime mbi kuadrin ligjor specific.

Në pjesën e dytë është përdorur metoda krahasuese dhe ajo e analizës, me synimin që të jepet një pasqyrë e modeleve ligjore të ndryshëm në rajon dhe analizimi i elementëve që respektivisht ndikojnë në çështjet e përzgjedhura për t'u shqyrtuar.

Ky hulumtim është kryer prej 15 janar 2017 – 20 mars 2017

QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi i hulumtimit është trajtimi i grupit të problematikave të evidentuara në shqyrtimin praktik të rasteve nga jeta, të cilat pengojnë gratë të gezojnë një gamë të gjërë të të drejtave pronësore dhe trashëgimore. Rrjedhimisht këto pengesa u mohojnë atyre të drejtën jo vetëm për të fituar të drejta pronësore, por edhe për ti pretenduar dhe mbrojtur në një process të rregullt, apo për ti ushtruar në mënyrë efikase ato. Evidentimet prej rasteve jetësore, nganjëherë edhe të përfolura publikisht, lidhen jo vetëm me interpretimin dhe zbatimin e duhur të parimeve të së drejtës, por gjithashtu edhe me cenime të rënda të rregullave procedurale të sistemit në vend.

Sikurse u përmend më sipër, me qëllim sqarimin llogjik të problematikave, disa prej tyre të trajtuara në këndvështrime të ndryshme, hulumtimi do të kalojë në tre faza. Analizimi i garancive dhe mangësive ligjore, procedurale dhe administrative që kufizojnë gratë nga trashëgimia e pronës, identifikimi pengesave të tjera kulturore që pengojnë femrat nga ushtrimi i kësaj kategorie të të drejtave pronësore, si edhe rekomandimi për mekanizma të nevojshëm për zgjidhje, me bazuar në modele në rajon apo perceptimin e popullatës. Kjo e fundit nxjerr lehtësisht në pah perceptimin mbi problematikat e pengesat dhe sesi ato mund të tejkalohen.

Studimi ka për qëllim analizimin e problematikave të mëposhtme:

- Edukimi dhe ngritja e nivelit të informimit mbi të drejtat pronësore dhe përfitimin e tyre;
- Përmirësimi i klimës shoqërore dhe institucionale për mbështetjen e grave;
- Realizimi i garancive procedurale.
- Vlerësimin e rëndësisë së burimeve njerëzore për eficientë organizative duhet të merren në konsideratë për të optimizuar performancën e gjykatave dhe agjensive shtetërore lidhur me çështjet e pronësisë. Ndryshimet institucionale dhe teknologjike që po ndodhin në Kosovë, kërkojnë një investim të dedikuar në kapitalin njerëzor.

Nëprmet identifikimit të fushave për ndërveprim dhe nxitje e zhvillimit të së drejtave pronësore do të analizohen rëndësia e edukimit dhe ndërtimit të vetëdijes të grave; shërbimet ligjore të ndihmës dhe mbështetje; avokimit dhe lobimit; hulumtimeve shkencore; reformës ligjore dhe institucionale etj.

1. NORMAT NDËRKOMBËTARE DHE KUADRI LIGJOR KOMBËTAR

Mirëqenia e çdo individi e konkretisht cdo gruaje është e lidhur ngushtë me respektimin e të drejtave dhe lirive të Njeriut. Në këtë kuadër, e drejta për të mbartur pronë është një e drejtë themelore e njeriut, edhe pse në praktikë, kjo e drejtë nuk gjen zbatim të barabartë për burrat dhe gratë. Është gjerësisht e ndeshur situata kur të afërmit e tyre, familjarët, ose autoritetet shtetërore u cenojnë këto të drejta grave. Madje, edhe vetë gratë, i mohojnë shpesh vetes të drejtat pronësore ose thjesht nuk i kërkojnë ato. Në këtë pikpamje, informimi i tyre mbi të drejtat që u njohin ligjet dhe aktet ndërkombëtare me objekt mbrojtjen e të drejtës së pronës është i ulët.

Korniza ligjore për rregullimin e të drejtave pronësore në Kosovë është definuar si një paketë ligjesh, akteve ndërkombëtare të ratifikuara, e rregulloreve, udhëzimeve administrative, vendime të praktikës gjyqësore dhe, të cilat ndërthuren për të krijuar një tërësi normash dhe duke burimin e së drejtës në zgjidhjen e kontesteve lidhur me pronësinë. Gjejmë vendin të shprehim edhe mendimin e konstatuar në qarqet e ndryshme të juristëve (studiues, avokatë, gjyqtarë etj.), sipas të cilëve këto akte kanë formalizuar një sistem të ndërlikuar rregullash, i cili krijon shpesh herë hapësira për keqinterpretime, deformime apo edhe shmangie e qëllimshme prej synimit të ligjvënësit.

Nisur prej nivelit më të lartë të hierarkisë së akteve dhe standarteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, kuadri ligjor në Republikën e Kosovës garanton të drejtat themelore me objekt garantimi e të drejtave pronësore. Legjislacioni në këtë fushë të marrëdhënieve shoqërore ka pësuar ndryshime të qënësishme në varësi të proceseve të rëndësishme historike, nëpër të cilat ka kaluar Kosova. Këtu kanë ndikuar masat e veçanta të ndërmarra nga ish sistemi socialist, problemet e shkaktuara nga lufta e fundit e vitit 1998-1999 dhe shumë faktorë të tjerë të cilët po ashtu ndërlidhen me themelimin e prezencës ndërkombëtare në Kosovë pas vitit 1999.

Legjislacioni i hartuar prej deri në vitin 1989, rregullon pothuajse në detaje marrëdhëniet themelore juridike pronësore, që kryesisht i referohet pronësisë shoqërore, si formë dominante e pronësisë në sistemin e kaluar të kaluara në vend. Sidomos prej vitit 1970 e deri në vitin 1989, janë nxirre një sërë ligjesh për rregullimin e çështjeve pronësore, një numër i të cilave edhe sot vazhdojnë të jenë të aplikueshme sipas rregullores së UNMIK-ut 1999/24². Shumica e këtyre ligjeve kanë sjellë komplikime të mëdha për sistemin juridik kosovar në fushën e marrëdhënieve pronësore-juridike, të cilat duke u shoqëruar edhe me procese të

² Aliu, Abdullah, E Drejta sendore (pronësia), Prishtinë 2006

zhvillimit të shoqërisë, krijoi një lëmsh problemesh ligjore e sociale. Pas vitit 1989, kur u bë suprimimi i autonomisë, fillon degradimi i sistemit juridik të Kosovës dhe instalimi i një sistemi tjetër të mbështetur në baza plotësisht diskriminuese.

Faza e tretë e krijimit të një sistemi të ri juridik në përputhje me parimet dhe vlerat universale, në Kosovë fillon pas vitit 1999. Bazuar në Rregulloren e përmendur më lartë të UNMIK-ut, nr. 1999/24, përcaktohet ligji i aplikueshëm në Kosovë, sipas të njëjtit mbesin jashtë kuadrit ligjor aktet ligjore të miratuara prej pushteti serb pas vitit 1989 dhe të klasifikuara si ligje diskriminuese.

Shumica e ligjeve në lidhje me të drejtat pronësore dhe të trashëgimisë së grave në Kosovë janë relativisht të reja, që datojnë nga themelimi i shtetit, ku ligji i parë është botuar në vitin 2003. Të gjitha të drejtat pronësore dhe transferimin e pronës në Kosovë për të gjithë shtetasit janë objekt i Ligji Nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore. Garantimi i qasjes së grave në pronë është përmbushur nëpërmjet ligjeve të tjera të lidhura në mënyrë të drejtëpërdrejtë me këto marrëdhënie, sic janë Ligji Nr. 2004 / 26 për Trashëgiminë, Ligji Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, Ligji Nr. 05/L -021 për mbrojtjen nga diskriminimi etj.

Të drejta pronësore të grave të parashikuar në legjislacion kombëtarë shprehimisht parashikohen në përputhje me standartet dhe normat ndërkombëtare për barazinë gjinore në sferat ekonomike dhe sociale. Kështu, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të vitit 2008, në nenin 7 (2) vë në dukje se “Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, duke dhënë mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe fushat e tjera të jetës shoqërore.” Për më tepër, Kushtetuta e Kosovës e ka përcaktuar qartësisht rolin e grave dhe burrave të barabartë në shoqëri duke përjashtuar cdo mundësi diskriminimi si vlerë themelore e sanksionuar nëpërmjet legjislacionit të bredshëm të veçantë dhe ratifikimit e konventave ndërkombëtare³ të përmendura në të. Konkretisht, bazuar edhe në nenin 24 (2) i Kushtetutës së Kosovës thotë se “Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare ose shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet,

³ Nenin 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës me qëllim garantimin e të drejtave themelore në përputhshmëri me konventat dhe aktet e tjera , rendit Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Gruas. “Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen në këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve tjera dhe akteve tjera të institucioneve publike.”

pronës, gjendjes ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose të ndonjë statusi tjetër personal.

Në këtë normë kushtetuese dhe themelore për rendin juridik është përcaktuar në mënyrë absolute përjashtimi nga zbatimi i cfarëdo akti ligji apo nënligjor i cili cënon të drejtat e mbrojtura nëpërmjet Konventave të ratifikuara në këtë fushë.

Në rrafshin ndërkombëtar E drejta e Pronësisë garantohet edhe me specifika nëpërmjet Traktateve ndërkombëtare në Ekonomike, Sociale dhe të Drejtat Kulturore dhe për të Drejtat Civile dhe Politike, Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të vitit 1948, dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut me Protokollet e saj⁴, Platforma për Veprim të miratuar në Konferencën e Katërt Botërore për Gratë të vitit 1995 të cilat nënvizojnë mbrojtje e grave nga diskriminimi, ruajtjen e pavarësisë së tyre financiare apo të drejtën e për të marr vendime mbi pasurinë në mënyrë të pavarur.

Po ku fillojnë problematikat në zbatimin legjisacionit dhe përfitimit të të drejtave pronësore prej grave? Ngelet për t'u sqaruar që të drejtat pronësore të grave përbëjnë një koncept të gjërë, ku përfshihen pushtet faktik dhe juridik mbi një send, nëpërmjet mjeteve apo mekanizmave të ndryshëm të fitimit të pronës⁵. Nëpërmjet një marrëveshje të heshtur kjo tematikë është trajtuhet gjerësiht me fokus rastet jetësore apo rrethanat kur personi të drejtën e vet të pronësisë e nxjerr nga e drejta e paraardhësit të tij. Ndodh kështu sepse, vëmendja është përqëndruar jo vetëm tek sigurimi i kushteve që gratë të fitojnë të drejta pronësore mbi bazën e punëve juridike të vullnetëshme, por mbi të gjitha të mbrojtjes së tyre në rastë e fitimit të pasurisë mbi bazën punëve juridike të njëanëshme (dhurimi, testamenti) e në veçanti të fitimit të pronës me trashëgimi.

1.1 Të drejtat pronësore në trashëgimi

Pozita e grave në lidhje me të drejtën e tyre për të trashëguar qëndron përballë një sërë pengesash sociale, ligjore dhe institucionale në Kosovë. Paragrafi 1 i nenit 3 të Ligjin për Trashegiminë i Kosovës përcakton se, “Të gjithë personat fizikë në kushte të njëjta janë të barabartë në trashëgimi”, duke definuar qartësisht se ndarja e trashëgimit mes anëtarëve të familjes pa përjashtuar

⁴ Neni 1, Protokoll 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Lirive Themelore të Njeriut miratuar më 18 maj 1954, themelon të drejtën për gëzim në qetësi të posedimeve dhe ndalon privimin nga posedimi, por me disa përjashtime; po aty, në nenin 13, që garanton të drejtën në “mjete efektive juridike pranë një autoriteti kombëtarë”; po aty. në nenin 6(1), i cili garanton të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor.

⁵ Nisur nga mënyrat e definuara juridikisht, e drejta e pronësisë fitohet në bazë të ligjit, në bazë punës juridike dhe me trashëgim, si dhe në bazë të vendimit të organit kompetent shtetëror

trashëgimtarë në baza gjinore. E megjithë këtë, situata e grave dhe vajzave në trashëgimi nuk mund të krahasohet me atë të trashëgimtarëve të tjerë.

Për një kohë shumë të gjatë, bashkëshortja është konsideruar si e huaj në familje. Kjo e fundit ndërtohej vetëm me lidhje gjaku. Si rrjedhojë e këtij parimi, bashkëshortja thirrej për të marrë pjesë në trashëgimi vetëm në rast se trashëgimlënësi s'kishte asnjë të afërm. Me kalimin e kohës konceptime të tilla filluan të ndryshonin. Sot, bashkëshortja është pjestar i vërtetë i familjes. Bashkëshorti është madje pjesëtari më i afërt e familjes, pavarësisht mungesës së lidhjes së gjakut. Këto të dhëna sociologjike kanë bërë që të ndryshojë edhe hierarkia e trashëgimtarëve. Qëllimi për këtë të fundit ka qenë që të përmirësojë gjithnjë e më shumë situatën e bashkëshortes pasjetuese, duke ruajtur në një lloj mënyre strukturën origjinale të sistemit.

Pengesat e kanë origjinën e tyre veçanërisht në mentalitetin maskilist të mbështetur në zhvillimin historik nga e drejta zakonore. Për këtë arsye është mjaft e rëndësishme që të njihen disa rregulla themelore që lidhen me të drejtën e trashëgimisë për gratë

Trashëgimia është kalimi i pasurisë nga personi i vdekur tek një ose më shumë persona të tjerë, trashëgimtarë të caktuar me ligj. Ky trashëgim mund të bëhet me ligj, ose me testament. Një grua do të fitonte statusin e trashëgimtares dhe njëherazi të titullarës së pronës në rast⁶ se ajo trashëgon pasardhësit e saj (prindi ose gjyshja për trashëgimlënësi që nuk kanë lënë trashëgimtarë), nëse ngelet e ve dhe trashëgon bashkëshortin pasjetues ose në rast se është një prej familjarëve të trashëgimlënësit në familjen e saj të vajzërisë (bija ose motra e trashëgimlënësit), e cila pavarësisht statusit civil (e martur ose jo) do të rradhitej me trashëgimtarët e tjerë ligjorë.

Bashkëshortja, në bazë të trashëgimisë me ligj, është trashëgimtar i radhës së parë, ndaj ajo thirret në radhë të parë, në trashëgim, së bashku me fëmijët. Të gjithë trashëgimtarët e radhës së parë trashëgojnë në pjesë të barabarta. Trashëgimia ligjore e mbron pjesën e trashëgimisë së bashkëshortit, pavarësisht nga numri i trashëgimtarëve të tjerë që mund të përfitojnë trashëgimi, në rast se një nga fëmijët e trashëgimlënësit ka vdekur më parë, ose në rast se përveç bashkëshortes nuk ka trashëgimtarë të tjerë të radhës së parë.

Në ligj nuk parashikohen specifikime mbi rrethana që lidhen me situatën ekonomike të bashkëshortëve pasjetues, e më konkretisht grave duke ju lënë të

⁶ Bazuar në nenin 11.1 të Ligjit për Trashëgiminë i Kosovës, “ Trashëgimtarë ligjorë janë: fëmijët e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti, prindërit, vëllëzërit e motrat dhe pasardhësit e tyre, gjyshi e gjyshja dhe pasardhësit e tyre”.

drejtën të trashëgojnë njësoj si në rastin kur gruaja është e aftë, edhe në rastin kur është e paaftë për punë.

Objektivi ligjor në të vërtetë duhet të jetë evitimi i shkaqeve dhe rrethanave që ndihmojnë që ajo të mos vihet në vështirësi dhe të mos dalë jashtë kuadrit të zakonshëm jetik të tij prej vdekjes së trashëgimlënësit. Në të njëjtën kohë, ky objektivi merr parasysh dhe anën financiare të bashkëshortes pasjetuese që të jetojë në kushte normale.

Në vende të ndryshme, për të përcaktuar situatën reale të bashkëshortit pasjeues, e më së shumti bashkëshortes analizohet fillimisht forma e regjimit martesor⁷. Kjo çështje është trajtuar gjerësisht në vijim të këtij studimi, duke përfshirë edhe sfidën për të garantuar këtë standart për gratë e mbetura të ve e që marrëdhënet familjere i kanë ngritur mbi bashkejetesën faktike.

Zanafilla e problematikave të ndeshura në praktikë lidhen më dy institute juridike të Ligjit për Trashëgiminë i Kosovës. Konkretisht ato lidhen me institutin e “heqjes dorë” nga e drejta për të trashëguar dhe shmangia nga trashëgimia.

Instituti i parë është trajtuar gjerësisht në studime me objekt të përafërt e padashur të përsëritemi do të trajtojmë natyrën juridike të këtij instrumenti të aplikuar në kundërshtim me qëllimin që ai mbart në vetvete.

Heqja dorë nga trashëgimia është shprehje e njëanëshme e vullnetit që ka për pasojë humbjen në myrë të pakthyeshme të të gjitha të drejtave që burojnë nga prona e trashëguar. Ky veprim ka për pasojë daljen nga rrethi i trashëgimtarëve dhe ndarjen e pjesës së tij nëpërmjet trashëgimtarëve të tjerë. Sikurse u përmend, heqja dorë nga trashëgimia nën presionin e trashëgimtarëve meshkuj për të arritur shmangien e gruas nga trashëgimia realizohet me mjete të lejuara ligjore, por shpesh herë në kundërshtim me qëllimin e ligjit. Themi në kundërshtim duke pasur parasysh raste kur gratë heqin dorë nga trashëgimia në emër të harmonisë familjare apo vllazërore, në emër të zakonit apo edhe për shkak të mashtrimit, frikës ose dhunës nga anëtarët meshkuj përfitues të trashëgimisë.

Bazuar në nenin 130 të Ligjit për trashëgiminë, trashëgimtari, i cili ka hequr dorë në emër të vet konsiderohet sikur të mos ketë qenë trashëgimtar. Ai mund të heq dorë nga trashëgimi me deklaratë të dhënë pranë gjykatës gjersa të përfundojë seanca mbi trashëgiminë. Heqja dorë vlen edhe për pasardhësit e atij që ka hequr dorë, përveç nëse shprehimisht ka deklaruar se hequr dorë vetëm në emër të vet. Në qoftë se pasardhësit janë të mitur për këtë heqje dorë nuk nevojitet leja e organit të kujdestarisë. Gjithashtu, në qoftë se për trashëgim

⁷ Beignier Bernard dhe Do Carmo Silva, Jean-Michel: Liquidations des régimes matrimoniaux et de successions

kanë hequr dorë të gjithë pasardhësit të cilët i takojnë radhës me të afërt të trashëgimisë në çastin e vdekjes të trashëgimlënësit, në trashëgim thirren pasardhësit e radhës pasuese të trashëgimit.

Nga analizimi i kësaj dispozitë të bien në sy dy problematika, me zgjidhjen e të cilave dhe në kushtet e Kosovës situata do të lehtësohej në mënyrë të drejtëpërdrejtë.

Kështu, bie në sy periudha e gjatë kohore, gjatë së cilës trashëgimtarja femër ruan të drejtën për të hequr dorë. Nisur edhe nga modele të tjera ligjore në rajon, ekziston mundësia që kjo koheqzgjatje e ushritit të së drejtës të jetë më e shkurtur duke zvogeluar shanset për presion në familje apo rrethana të tjera, që e cojnë trashëgimtarin të heqë dorë. Rekomandojmë që zvogelimi i këtij afati, përsëritur një deri në tre muaj pas hapjes së trashëgimisë, do ndikonte në zvogelimin e rasteve kur trashëgimtarët heqin dorë. Të mos harojmë që ky institut ka indur me qëllimin për të mbrojtur trashëgimtarët nga barra financiare që rëndojnë trashëgiminë e që kjo e fundit të mos kthehet në një mënyrë për të demtuar interesin e trashëgimtarit. Pra, heqja dorë subjektivisht nuk konsiderohet si një mundësi e bazuar thjesht në dëshirën apo peshën morale të trashëgimtares femër, përse kohë në thelb ngelet një mjet ligjor për të privuar veten nga një e drejtë.

Në këtë drejtim është ezigjencë e kohës ngritja e vetëdijes së grave se heqja dorë nga trashëgimia i con në privim nga të drejta pasurore dhe varësia ekonomike, në të cilën vendosen pas heqjes dorë nga të drejtat ngushton hapësirën e shumë të drejtave të tjera në familje dhe shoqëri.

Përfitimi prej këtij mekanizmi apo mjeti ligjor, duke dal nga konteksti për të cilin është parashikuar apo duke përjashtuar trashëgimtarët pa ushtruar formalisht të drejtën për të hequr dorë, siç janë edhe rastet kur ata jetojnë jashtë vendit, është kthyer në të mundësi "me cen".

Shprehja e vullnetit në formën e deklaratës nevojitet të verifikohet zyrtarisht në gjykatë. Për këtë rekomandohet këmbngulja dhe angazhimi i lartë i gjyqtarëve në verifikimin e vullnetit të trashëgimtares nga njëra anë dhe organizimi i aktiviteteve trajnuese për gjyqtarët nga Këshilli gjyqësor apo institucionet e linjës me qëllim ndërfaqësor e metodave më të mira të praktikës profesionale në këtë drejtim.

Shmangia dhe njëherazi përjashtimi i grave nga trashëgimi në mënyra të veçanta është realizuar edhe nëpërmjet veprimeve që mbartin në vetvete elementë të veprës penale, e që me gjithë këtë ndodh të aplikohen. Kështu, me vdekjen e trashëgimlënësit dhe nisjes së procedurës për hapjen e trashëgimisë pasi hartohet Aktvdekja. Kjo e fundit ka si pjesë përmbajtësore edhe shënimin e

trashëgimtarëve sipas rradhës së trashëgimit. Në rast se në këtë etapë të procedurës nuk depozitohen certifikatat e lindjes së trashëgimtareve femra në zyrën e gjendjes civile, këto të fundit mund të shmangen nga trashëgimi duke mos u shënuar në Aktvdekje.

Aktivdekja është lëshuar nga Organi komunal i shërbimit, kompetent për mbajtjen e librit amzë të vdekjeve ka për detyrë që, i dërgohet brenda afatit prej 15 ditësh nga dita në të cilën e ka regjistruar vdekjen, t'ia dërgojë aktivdekjen gjykatës trashëgimore. Bazuar në nenin 134 të Ligjit Nr. 03/L-007 Për Procedurën Jokontestimore aktivdekja hartohet në bazë të të dhënave që janë marrë nga kushërinjtë e personit të vdekur, nga personat me të cilët ka bashkëjetuar i vdekuri, si dhe nga personat e tjerë që mund të japin të dhëna që shënohen në aktivdekjen. Në rastet e hapjes së trashëgimisë nga noteri Aktivdekja përbën akt noterial prej të cilit fillojë procesin e përgatitjes së Deklaratës së Trashëgimisë, duke e ndarë formalisht pasurinë bazuar vetëm në trashëgimtarët e listuar.

Parashikimi i të drejtës së ankimit dhe parashkrimi i kësaj të drejte në rast shmangie nga trashëgimtarët krijon një garanci për të mbrojtur gratë në të tilla raste nga cënimii të drejtës ligjore. Bazuar në intervistimet e gjykatësve dhe noterëve, të kryera nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative në vitin 2016, lidhur me këtë hulumtim specifik mbi të drejtën e grave për trashëgim në prone, janë konstatuar raste në përvojën e tyre kur familjet janë munduar t'i fshehin trashëgimtarët⁸. Ky fakt e bën situatën edhe më therëse, përse kohë të tilla veprime nuk raportohen dhe kallzohen nën presionin e faktorëve nga më të ndryshëm si mungesa e dijenisë mbi të drejtën dhe shmangies prej saj, frikës, presionit familjar apo vetë ndrydhjes së lirisë së grave. Tek këto të dalë nga dëshmi të grave të intervistuar gjerësisht gjatë Kampanjave të zhvilluara nga Klinikat Ligjore për Ndihmë Juridike Falas nga CLARD dhe klinika ligjore pranë Kolegjit ILIRIA dhe rasteve të shqyrtuar, vërehet edhe elementi i shpresës për ndryshime nga vajzat dhe gratë e moshave më të reja. Faktori moshë rezulton të theksojë më shumë perceptimin mbi të drejtën e mbartjes së një prone dhe prirjes për të përjashtuar apo vetëpërjashtuar gratë nga të drejtat trashëgimore dhe pronësore në emër të ashtuquajturës “përrulje ndaj zakonisht”.

Problematika e dytë është edhe më e mprehtë dhe lidhet me mundësinë e parashikuar në ligj që lejon prindërit që të heqin dorë nga e drejta e trashëgimisë së pasardhësve të mitur, pa miratim nga organi i kujdestarisë.

⁸ Raporti i BIRN pë të Drejtën e Grave për Trashëgim në Pronë, Korrik 2016, faqe 8

Prindërit janë kujdestarët ligjorë, të cilët mund të ushtrojnë përgjegjësinë ligjore në interes të fëmijëve. Përgjegjësia prindërore përfshin të drejtat dhe detyrat që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë⁹. Nisur nga parimi i sigurisë juridike kryerja e veprimeve të administrimit jo të zakonshëm (veprime juridike, të cilat mund të ndryshojnë fatin e pasurisë së fëmijës) të pasurisë së fëmijës nuk mund të bëhet vetëm me autorizimin apo lejen paraprake të Organit kompetent të Kujdestarisë¹⁰. Këto dispozita jo vetëm që përfaqësojnë një kontraditë ligjore duke pasur parasysh që vendimi për të përjashtuar një të mitur nga trashëgimia është një veprim nga kategoria e tagrit të disponimit apo tjetërsimit të pasurisë. Për më tepër, nën kontekstin e mendësisë që rezulton në shoqëri dhe diferencimeve gjinore që bëjnë prindërit e synimin që pasuria duhet të ngelet në familje, kjo do të mundësonte lehtësisht shmangien nga trashëgimia të vajzave të mitura, megjithëse kjo e drejtë u buron parimisht nga ligji.

Përkundër një progresi të madh në dekadën e fundit, Kosova është ende pjesë e sfidës globale të përmirësimit të barazisë gjinore duke përfshirë këtu, qasjen jo të barabartë të grave në burime ekonomike dhe natyrore.

1.2 Të drejtat pronësore prej bashkësisë martesore dhe jashtëmartesore

Martesa është një veprim juridik i secilit prej bashkëshortëve, i cili sjell si pasojë jo vetëm ndryshimin e statusit të tyre personal, por edhe ndryshimin e regjimit juridik që do të zbatohet për të drejtat pronësore të fituara gjatë martesës. Nëpërmjet institutit të “regjimit pasuror martesor¹¹” bashkëshortët fitojnë sigurinë juridike të përcaktimit të të drejtave mbi pasuritë që do të fitohen gjatë martesës. Sipas Gjykatës Europiane të Drejtësisë¹² regjimi pasuror martesor përfshin jo vetëm regjimin pasuror në kuptimin e ngushtë të tij, por përfshin gjithashtu të gjitha marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve që rrjedhin nga

⁹ Neni 128, paragrafi 4 I Ligjit për Familjen i Kosovës

¹⁰ Neni 135 Ligji për Familjen (1) Prindërit, të ardhurat nga pasuria e fëmijës së tyre mund t'i disponojnë, në radhë të parë: për ushqimin, edukimin dhe arsimimin e tij, si dhe për nevojat e domosdoshme të bashkësisë familjare, nëse nuk kanë mjete të mjaftueshme. (2) Prindërit me lejen e Organit kompetent të Kujdestarisë mund ta tjetërsojnë ose ta ngarkojnë pasurinë e fëmijës vetëm për mbajtje, kujdes dhe edukim.

¹¹ Me regjim pasuror martesor do të kuptojmë tërësinë e normave ligjore, të cilat kanë për objekt rregullimin e marrëdhënieve pasurore ndërmjet bashkëshortëve gjatë martesës, dhe marrëdhënieve ndërmjet tyre dhe të tretëve.

Për më tepër shih: Sonila Omari, E drejta familjare, Botimet Morava, Tiranë 2010

¹² Vendim i GJED C-143/78, 17 Mars 1979 “Jacques de Cavel vs Louise de Cavel

martesa ose nga zgjidhja e saj (vendimet/masat e përkohshme dhe definitive të rregullimit të marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës).

Regjimi i bashkësisë së pasurive të përcaktuar në Ligjin për Familjen, konsiderohet si regjimi më i përshtatshëm për rregullimin e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve, si regjimi pasuror, që garanton barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve gjatë martesës. Kështu, Kosova nuk renditet ende ndër vendet që kanë parashikuar edhe regjimin kontraktor, si zgjidhje konvencionale e bashkëshortëve për rregullimin e marrëdhënieve pasurore në martesë.

Mbrojtja kushtetuese¹³ dhe ajo e ligjit për familjen mbron të drejtat e grave jo vetëm për të hyrë me vullnet të lirë në martesë, por edhe të zotërojnë së bashku pronën e fituar gjatë martesës së tyre, dhe të ruajnë pronësinë e veçantë të pasurisë që sjellin në martesë.

Bazuar në nenin 45 të Ligjit nr. 2004/32 Ligji për familjen i Kosovës, bashkëshortët mund të zotërojnë së bashku pronën e fituar gjatë martesës së tyre, dhe të ruajnë pronësinë e veçantë të pasurisë që sjellin në martesë. Për më tepër bashkëshortët garantojnë në të drejtat e tyre jo vetëm duke vendosur sistemin e bashkëpronësisë mbi pasurinë e fituar nga secili bashkëshort gjatë martesës¹⁴, por edhe nëpërmjet vendosjes së barazisë në administrimin e kësaj pasurie¹⁵.

C'ka është edhe më e rëndësishme, regjimi i bashkësisë ligjore, gjithashtu, garanton njohjen dhe vlerësimin me të njëjtën rëndësi jo vetëm të kontributit monetar të bashkëshortëve në fitimin e pasurisë gjatë martesës, por edhe të kontributit në natyrë, në drejtim të aktivitetit shtëpiak dhe rritjes dhe edukimit të fëmijëve, duke prezumuar në mënyrë absolute se ky kontribut ka bërë të mundur fitimin e pasurisë ndërmjet bashkëshortëve, gjatë martesës¹⁶.

U nisëm nga kjo analizë sistematike për të theksuar argumente, të cilat në momentin e trajtimit të problematikave ato rezultojnë çështje të pazgjidhura dhe

¹³ Shih Neni 37 (2) i Kushtetutës "Martesa dhe shkurorëzimi rregullohen me ligj dhe bazohen në barazinë e bashkëshortëve".

¹⁴ Neni 47- Pasuria e përbashkët

(1) Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimin të martesës, si edhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë; (2) Pasuria e përbashkët mund të përfshijë gjithashtu të drejtat sendore dhe të detyrimeve; (3) Pasuria e bashkëshortëve e fituar bashkërisht përmes lojërave të fatit konsiderohet pasuri e përbashkët.

(4) Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse ndryshe nuk janë marrë vesh;

¹⁵ Neni 49 - Pasurinë e përbashkët bashkëshortore gjatë martesës bashkëshortët e administrojnë dhe e disponojnë bashkërisht dhe me marrëveshje

¹⁶ Sonila Omari, E drejta familjare, Botimet Morava, Tiranë 2010

pretendime të pabazuara kundër të drejtës së grave për të qenë, edhe ato sëbashku me bashkëshortët, titullare të pronës së fituar gjatë martesës.

Pretendimet e hasuara në praktikë për të evituar gratë prej pasurisë së përbashkët martesore me argumentin e ngushtë për mungesë të kontributit financiar, thekson nevojën për:

- të nënvizuar barazinë midis kontributit financiar dhe atij në natyrë për mbarëvajtjen e familjes dhe

- të shmangur mundësinë e lënë nga ligji në pikën 4 të nenit 47, për mundësinë e marrëveshjes midis bashkëshortëve për të pasur pjesë të barabarta në pasuri.

Sikurse e theksuam më lartë, rëndësia e barabartë e kontributit financiar dhe atij në natyrë për familjen, u garanton grave të pretendojnë të drejta pasurore, edhe në mungesë të kontributit financiar prej punës¹⁷.

Në kushtet e numrit të lartë të grave të papunësuar apo që nuk kërkojnë të punësohen për rrethana të ndryshme, një kusht i tillë do tu garantonte atyre përmbushje të pakushtëzuar të së drejtës për të marr pjesë në pasurinë e përbashkët martesore. Gjithashtu, megjithë rëndësinë juridike që mbart autonomia e vullneteve të bashkëshortëve, vendosja e parashikimeve lejuese për shmangie nga e drejta e bashkëshortes për pjesë të barabarta në pasuri, do të hapte rrugën për arritjen e marrëveshjeve nën ndërhyrjen e faktorëve të jashtëm (kanosje, mashtrim ose lajthim, të cilat cojnë në pavlefshmëri të marrëveshjeve, por që shpesh ngelen të pakontestuar).

Në vijimësi të problemeve të hasuara në përfitimin e të drejtave pronësore të grave të martuara, ekzistojnë disa zbrazëtira lidhur me këto të drejta në bashkësitë jashtëmartesore apo martesave faktike të krijuara.

Neni 14 i Ligjit për Familjen përcakton martesën si “bashkësi e regjistruar ligjrisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes”. Me gjithë këtë, konsiderohen të lidhur në bashkësi faktike edhe burri dhe gruaja, të cilët sipas nenit 39 të Ligjit për familjen, jetojnë në çifte, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie. Kjo bashkësi faktike gëzon status të barabartë me statusin martesor në aspektin e të drejtave dhe detyrimeve për përkujdesje, mbështetje financiare reciproke, dhe të drejtave pasurore ashtu siç është specifikuar në ligj.

Ajo që vërehet qartësisht nga interpretimi i këtyre dispozitave është:

¹⁷ Agjencia e statistikave të Kosovës _

http://askdata.rks.gov.net/PXËeb/pxëeb/sq/askdata/askdata_Labour%20market_Quarterly%20labour%20market_Employment/lfsq01.px/table/tableVieLayout1/?rxid=a98567f0-5ade-480f-b2ea-d8d314769ffa

- Synimi për të barazuar kushtet dhe efektet e bashkësisë martesore dhe asaj jashtmartesore;
- Mungesa e përputhshmërisë me ligjin e trashëgimisë, i cili vendos standardet më të larta për njohjen e një bashkëshorti në bashkësi faktike.

Tendenca për të barazuar dy lloj marrëdhëniesh, të cilat janë të ngjashme në thelb, por jo në pasojat që vijnë për “personat¹⁸”, vjen si rezultat i numrit të lartë të martesave faktike të lidhura në Kosovë.

Një tjetër moment ky i rëndësisë që kanë normat zakonore në drejtim të krijimit të lidhjeve martesore pa kryer formalizimin e tyre në Komunë. Konsiderojmë si të rëndësishme që bashkë me një përkufizim më të saktë të këtyre marrëdhënieve familjare faktike, të klasifikohen edhe kushtet formale në bazë të të cilave bashkëshortja do të fitonte të drejta mbi pasurinë e fituar në bashkëjetesë dhe pasurisë në rast të vdekjes së partnerit bashkëjetues. Për momentin bazuar në nenin 89¹⁹ dhe veçanërisht në paragrafin 2 të nenit 90²⁰ të Ligjit për Familjen, të drejtat pronësore që parashikohen për bashkëshortët gjatë martesës ose pas shkurorëzimit, lënë të kuptohet që këto të drejta bëhen të pretendueshme në rast të një lidhje martesore apo e thënë ndryshe për personat që kanë statusin e bashkëshortëve. Ndërsa në klauzolat e tjera, ligji është i qartë për atë se marrëdhëniet pronësore midis bashkëshortëve në bashkësi faktike duhet të jenë njëjta me ato në një martesë të regjistruar ligjërisht. Kjo situatë ligjore në ligjin e

¹⁸ Ligji në fuqi për familjen përdor termin “burri dhe gruaja që jetojnë në çift” ose “personat”, të cilat nuk janë termat adekuat për të përshkruar bashkëjetuesit apo e thënë ndryshe partnerët bashkëjetues. Këta persona nuk mund të marrin statusin bashkëshort, ndaj ngelen të kategorizohen si partner. Ndërsa neni 11.2 i Ligjit për trashëgiminë e përkufizon si “bashkësia jetësore e gruas së pamartuar dhe e burrit të pamartuar e cila ka zgjatur një kohë të gjatë dhe që ka pushuar me vdekjen e trashëgimlënësit, me kusht të kenë qenë plotësuar prezumimet për vlefshmërinë e martesës”, duke ju dhënë edhe statusin me një formulim ambig si “bashkëshort jashtëmartesorë”. Ky term normalisht qëndron shumë larg të vërtetës së marrëdhëneve në bashkësitë jashtëmartesore, të cilët jetojnë si burrë e grua megjithë situatën e krijuar në vend për shkak të nënvlerësimit të lidhjes së martesave civile.

¹⁹ Neni 89 - Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve mund të kërkohet gjatë martesës dhe pas mbarimit të saj me shkurorëzim.

²⁰ Neni 90 - (1) Me rastin e pjesëtimit të pasurisë së përbashkët, borxhi i pasurisë së përbashkët do të llogaritet në pjesën e secilit bashkëshort.

(2) Kur bëhet pjesëtimi i pasurisë me kërkesë të njërit prej bashkëshortëve të një martese ligjërisht të regjistruar, duhet kushtuar vëmendje për të siguruar që pjesa e tij/saj përfshin ato sende të pasurisë së përbashkët, të cilët i shërbejnë zanatit apo profesionit të tij/saj.

(3) Nëse vlera e sendeve nga paragrafi 2 i këtij neni është jo proporcionalisht e madhe në krahasim me vlerën e pasurisë së përgjithshme të përbashkët, do të bëhet pjesëtimi edhe i atyre sendeve, përveç nëse bashkëshorti të cilit këto pjesë duhet t’i takojnë nuk ia siguron bashkëshortit tjetër pagimin përkatës në para apo vlerën përkatëse ose të përafërt ose nuk ia cedon bashkëshortit tjetër sipas pëlqimit të tij sendet e tjera me vlerë përkatëse ose të përafërt. Për këto kompensime qëllimi kërkohet të miratohet nga të dy bashkëshortët.

(4) Kur pjesëtimi fillohet me kërkesën e njërit bashkëshort, atij do t’i dorëzohen ato sende të pasurisë së përbashkët që i shërbejnë ekskluzivisht përdorimit të tij personal.

posaçëm të marrëdhënieve familjare lë pa rregulluar marrëdhëniet pasurore mes personave që jetojnë në bashkësi jashtëmartesore dhe për më tepër gratë si kategoria më e pambrojtur në to.

Analizimi i këtyre çështjeve nga doktrina juridike e ka gjetur zgjidhjen në dispozitën 28 të Ligjit për trashëgiminë, i cili ka kushtëzuar të drejtën për të trashëguar të burrit apo gruas që bashkëjetojnë. Sipas kësaj dispozite “Burri dhe gruaja që bashkëjetojnë në një bashkësi jashtëmartesore mund të trashëgojnë njëri-tjetrin si bashkëshortë, nëse:

a. Bashkësia jashtëmartesore deri në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit ka zgjatur të paktën 10 vjet, e nëse nga kjo marrëdhënie kanë lindur fëmijë të paktën 5 vjet dhe

b. Në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit as njëri nga personat që kanë bashkëjetuar të mos ketë qenë ligjërisht i martuar me ndonjë person të tretë, ose nëse trashëgimlënësi ka qenë ligjërisht i martuar me personin e tretë, ka paraqitur padi për shkurorëzimin ose nulimin e martesës dhe pas vdekjes së tij konstatohet se padia ka pasur mbështetje.

(2) Personat që kanë bashkëjetuar nuk konsiderohen si trashëgimtar të domosdoshëm.

(3) Personi që ka bashkëjetuar nuk ka të drejtën e trashëgimit nëse çifti nuk ka jetuar për një kohë të gjatë së bashku”.

Së pari parashikimi i të drejtës për të trashëguar në kushtet e pikës (b) të paragrafit 1 nuk garanton një të drejtë absolute për të trashëguar personin bashkëjetues. Kjo nuk do të tingellonte një cënim, përse kohë edhe në vende të tjera e drejta për të trashëguar është një nga efektet e lidhjes së martesës. Për më tepër nuk do të konsiderohej një cënim nëse numri i çifteve që jetojnë në bashkësi faktike nuk do të ishte kaq i lartë.

Së dyti situata juridike e institutit të bashkësisë faktike nevojitet të trajtohet në përputhje me Ligjin për trashëgiminë e mbi të gjitha të përkufizohet në një regjim më të qartë. Me këtë kuptojmë futjen e bashkësisë faktike brenda një kornize më rigoroze dhe të qartë ligjore, për ta kthyer këtë institut në një marrëdhënie të vazhdueshme që mund të konsolidohet dhe të marrë automatikisht efektet e martesës. Kështu nisur nga eksperiencia e vendeve të tjera do të mund të pranohej si zgjidhje vendosja e kushtit për të regjistruar bashkësitë faktike dhe njohjen e këtyre efekteve pas disa viteve bashkëjetsë²¹.

²¹ Kroacia dhe Bosnje dhe Hercegovina kërkojnë tre vjet bashkëjetesë para njohjes së bashkëjetesës. Ndërkohë kjo kohezgjatje mund të jetë edhe më e vogël në kushtet e lindjes së fëmijëve.

Për më tepër do të donim të shtrinin analizën ligjore edhe mbi një parashikim tjetër ligjor, në dukje i drejtë.

Referuar nenit 14/1 dhe 2²² të Ligjit për Trashëgiminë i Kosovës, në rast se i vdekuri nuk lë trashëgimtarë të tjerë përveç bashkëshortit, thirren trashëgimtarët e parashikuar në nenin 14 si: prindërit e trashëgimlënësit si dhe pasardhësit tyre (vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit), nipat e stërnipat e tij dhe pasardhësit e largët të tij, sipas dispozitës 15 të ligjit. Problemi në këtë dispozitë qëndron në faktin se në çdo rast, bashkëshorti merr vetëm gjysmën e trashëgimisë, pavarësisht trashëgimtarëve të tjerë që mund të thirren. Për më tepër vërehet një kontraditë dispozitash që jo vetëm krijon paqartësi dhe mundësi interpretimi rast pas rasti, por edhe ul besimin në një kuadër ligjor të mirë-rregulluar. Kështu për më tepër qartësi po vendosim tre dispozita kontradiktore të ligjit, te cilat dukshëm të lënë të kuptosh edhe konfuzionin për ti dhënë një drejtim modelit më të mirë për të garantuar bashkëshortin pasjetues në trashëgiminë e pronës.

Neni 14.4	Neni 15.1 dhe 15.2	Neni 17
<p>Në qoftë se të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para tij, bashkëshorti trashëgon tërë pasurinë</p>	<p>1.Në qoftë se njëri nga prindët e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i takonte sikur të kishte jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë fëmijët e tij (vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit), nipat e stërnipat e tij dhe pasardhësit e largët të tij, sipas dispozitave të këtij Ligji që vlejné për rastin kur trashëgimlënësin e trashëgojnë fëmijët dhe pasardhësit e tjerë të tij.</p> <p>2. Në qoftë se të dy prindët e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i takonte secilit prej tyre sikur të kishin jetuar pas trashëgimlënësit e</p>	<p>Në qoftë se të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit e nuk kanë lënë asnjë pasardhës, tërë pasurinë trashëgimore e trashëgon bashkëshorti i trashëgimlënësit.</p>

²² Neni 14 – 1. Pasurinë e trashëgimlënësit që nuk ka lënë pasardhës e trashëgojnë prindërit e tij dhe bashkëshorti i tij.

2.Prindërit e trashëgimlënësit trashëgojnë gjysmën e pasurisë në pjesë të barabarta, kurse gjysmën tjetër të pasurisë e trashëgon bashkëshorti i trashëgimlënësit.

	<p>trashëgojnë pasardhësit përkatës, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.</p>	
--	---	--

Sikurse duket qartë pozitat e bashkëshortit pasjetues kalojnë prej rregullimit parimor si në rast të mungesës së trashëgimtarëve të rradhës së parë (femijëve) dhe prindërve të trashëgimtarëve, si trashëgimtari i vetëm. Kjo përfaqëson një prej modeleve më të arrira të përkrahjes ligjore për bashkëshortin trashëgimtar.

Ndërkohë neni 15 dukshëm tregon se në rastet kur njëri prej prindërve apo të dy prindërit e trashëgimtarëve kanë vdekur para trashëgimtarëve, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i takonte secilit prej tyre sikur të kishin jetuar pas trashëgimtarëve e trashëgojnë pasardhësit përkatës. Dhe situata ligjore qartësohet në këtë interpretim sistematik nëpërmjet nenit 17, ku në fakt sqarohet vullneti i ligjvënësit për bashkëshortin pasjetues. Ai do të jetë trashëgimtari i vetëm jo në cdo rast siç parashikon neni 14.4, por vetëm në rastet kur në thirrjen e tij me trashëgimtarët e rradhës së dytë (prindërit), ata nuk kanë lënë asnjë pasardhës.

Pra, pozita e bashkëshortit/es pasjetues nuk mund të lejohet të përkeqësohet nga fakti se ai nuk mbetet trashëgimtari i vetëm i rradhës së parë.

Përvoja e vendeve europiane tregon që mund të bëhet akoma më shumë. Bashkëshorti pasjetues mund të ketë të drejtën që të jetojë në banesën në të cilën jetonte para se të vdiste trashëgimtarëve. Kjo gjë është parashikuar në legjislacionin francez, sipas të cilit kjo e drejtë banimi është e përkohshme dhe mund të zgjasë deri në 1 vit pas vdekjes së trashëgimtarëve. Kjo do të sigurojë bashkëshortin pasjetues të përdorë gjithashtu dhe sendet që mobilojnë shtëpinë. Në qoftë se banesa është pronë e përbashkët apo pronë personale e trashëgimtarëve, atëherë qëndrimi në të bëhet falas e në rastet kur banesa është dhënë me qera, atëherë bashkëshorti pasjetues përfiton qeranë për një periudhë të caktuar.

Kjo përpjekje është bërë në mënyrë që bashkëshorti pasjetues të ketë një jetë normale edhe pas një fatkeqësie të tillë. Pas këtij afati, trashëgimtarët e tjerë ligjorë mund të kërkojnë atë që iu takon. Në realitetin Kosovar kjo do të ndihmonte gratë të forconin pozitat e tyre përballë trashëgimtarëve të tjerë e t'u jepte kohë të mbronin të drejtat e tyre edhe në rast kur përballen me padrejtësi të caktuara brenda familjarëve të bashkëshortit.

Në përfundim të këtij trajtimi konsiderojmë që baza ligjore e koordinuar midis dy ligjeve paraqet kushte përjashtuese nga e drejta për të trashëguar për personat

që janë në bashkësi jashtëmartesore, në rast se njëri prej tyre vdes. Meqënëse fokusi i këtij studimi janë gratë dhe ato paraqiten në nivel shumë të ulët si zotëruese të pronave, ngelet të kuptohet që këto rregullime cënojnë drejtëpërdrejtë dhe në mënyrë disfavorizuese gratë në Kosovë. Përjashtimi nga e drejta për të trashëguar në rastet e bashkësive faktike përfaqëson një pjesë të konsiderueshme të grave të cilat gjenden në kushtet e mungesave të burimeve financiare apo minimalisht të shtëpisë së banimit, pra në mëshirën e fatit dhe humanitetit të familjarëve.

Në këto kushte konsiderojmë si të domosdoshëm reagimin në dy drejtime:

1. Ndryshimin e kuadrit ligjor si në aspektin e saktësisë dhe qartësisë terminologjike të parashikimeve, ashtu edhe balancimin midis kushteve për të njohur bashkësitë faktike dhe pasojave legjitime të burrit dhe gruas që jetojnë në çift.

2. Inkurajimin e çifteve të martuar apo që janë në premtim për martesë të shkojnë drejt formalizimit të jetës në çift nëpërmjet instrumentit më legjitim të njohur në botë, martesës civile. Kjo mund të arrihet nëpërmjet lehtësimeve të caktuara për çiftet që tashmë jetojnë në bashkësi faktike apo ndërgjegjësimit të atyre që futen në marrëdhënie në çift për ndryshimin në efektet e këtyre marrëdhënieve familjare, sa të ngjashme në thelb, aq edhe të ndryshme në formë.

Sundimi i ligjit në Kosovë karakterizohet me të drejta pronësore të definuara dhe të zbatuara dobët, sidomos të drejtat pronësore të femrave dhe grupeve minoritare. Në vitin 2016, femrat posedonin vetëm 18% të pasurisë së patundshme në Kosovë, duke përfshirë edhe tokën (Raport i Agjencionit Kadastral për pronësi të pronës në Kosovë).

Mungesa e një aplikimi efikas të të drejtave pronësore e dobëson qeverisjen demokratike, negativisht ndikon në të drejtat e njeriut, shfuqizon femrat dhe pengon rritjen e qëndrueshme ekonomike.

2. TË DREJTAT PRONËSORE NË KONTEKSTIN E TË DREJTËS ZAKONORE

Zanafilla e mënyrës të perceptimit dhe njohjes së të drejtës së grave për të pasur pronë, i gjejmë në rregullat zakonore, të cilat në të vërtetë janë proces normal i çdo shoqërie në etapa të ndryshme të zhvillimit të saj. Fuqia e normave zakonore, të njohura me emërtimin “kanun” në veri të trevave shqiptare të asaj kohe²³, të zbatuara në një rrjedhë kohore të caktuar, janë objekt i shumë studimeve, për efektet që patën ato në krijimin e traditave që i rezistuan edhe rregullave të shkruara në formën e burimeve të mirëfillta të së drejtës pozitive.

E drejta zakonore shqiptare nuk u lind nga një legjislator dhe as nga një parlament, ajo i paraprin shtetit, është e pashkruar dhe e transmetuar gojarisht brez pas brezi për gati 500 vjet rradhazi²⁴.

Të bën përshtypje fakti sesi ai është një ndër të paktat koncepte që të rinjtë e njohin dhe e përmendin natyrshëm në Kosovë. Njohja e historisë gjithnjë ka përfaqësuar një pikë suksesi dhe forcë në përcaktimin e mënyrës së zhvillimit të shoqërisë në vende të ndryshme në mbarë botën. Rregullat e zbatuara në një periudhë të caktuar, në një vend, reflektojnë për faktorë të rëndësishëm në një shoqëri dhe patjetër që njohja e tyre identifikon mekanizmat dhe vendimarrjet politike në vend. Nuk duhet të harrojmë, se kur flasim për rolin dhe forcën e Kanunit, ndodhemi në një shoqëri mesjetare dhe më vonë në një shoqëri feudale, ku nuk ushtrohej asnjë pushtet shtetëror në kuptimin e vërtetë të fjalës, ose kur ky pushtet ishte shumë i dobët e sidomos kur ishte i diktuar nga pushtuesit e huaj. Pra zbatimi i tij në periudhën e gjatë historike nga mesjeta deri në fillimin e shekullit XX, shoqërohej me kushtet e kohës ku pjesa masive e popullatës rurale, e qeveriste jetën, aktivitetet politike, sociale dhe ushtarake sipas rregullave dhe normave, që diktonte Kanuni, e drejta zakonore që ka qenë aktive dhe është zbatuar në mënyrë aktive për shumë shekuj në trojet shqiptare.

Megjithatë, efekti i këtyre normave zakonore duhet të shoqërohet me kalimin e kohës nga një zbehje progresive e fuqisë zbatuese, në të kundërt do të shëndrroheshin në një pikë kthese nga rruga normale e zhvillimit social dhe ekonomik në vend. Natyrisht në një shtet modern, ligjet e rregullat e Kanunit e humbin forcën vepruese, ndërsa në një shtet të dobët, ku nuk realizohet shteti i të drejtës, ku nuk veprojnë ligjet, krijohet një terren i pershtatshëm për rishfaqjen dhe riaktivizimin e aspekteve më negative të Kanunit, si vetegjyqësia, diskriminimi gjinor i grave, që lëndojnë progresin dhe modernizimin e shoqërisë.

²³ Kanun, etimologjikisht rrjedh nga fjala latine canon që do të thote rregull ose ligj, ose dicka që përdoret në mënyrë të rregullt, e njëjta gjë mund të thuhet edhe për fjalën e përdorur në jugun e trevave shqiptare “Venom”. Shpeshere, e drejta zakonore lidhet ngushtë me termin e përdorur me frekuencë Kanun, për faktin se e vetmja e drejte e kodifikuar dhe e përmbledhur është Kanuni i Lek Dukagjinit, i hedhur në letër vetëm në fillim të viteve 1900 nga prifti franceskan Dom Stefan Gjecovi.

²⁴ E. Farruku “Il Kanun , L'onore degli albanesi tra passato e presente . Annalisi di un fenomeno e culturale “Rivista Giuridica Stato e Chiesa, Roma, 2011.

Kanuni definohet si në kod i te drejtes zakonore, thellesisht i mbjelle ne ndergjegjien e popullit shqiptar²⁵. Konsolidimi i shtetit e mënjanoi këtë të drejtë, por kurrë nuk u fshi plotësisht nga vetëdija e njerëzve. Ky fakt është theksuar edhe më shumë nga popullata e nxitur për të ruajtur këto rregulla etiko-morale si një nga mënyrat e mbijetesës ndaj ndërhyrjeve të okupesve apo faktorëve të jashtëm²⁶. Në këtë llogjikë, hendeku midis regjimit të përcaktuar në ligj për përmbushjen e të drejtave të grave dhe normave shoqërore apo praktikave zakonore në këto çështje, është ngulitur si rezultat i nacionalizmit të rilindur në kontekstin e luftës së Kosovës për pavarësi dhe idesë për të forcuar rolin e burrave në familje e shoqëri.

Për të krijuar një ide sa më të saktë në lidhje me marrëdhëniet pasurore në familje dhe të drejtat pronësore të grave sipas të drejtës zakonore, si fillim duhet të mbajmë parasysh strukturën familjare dhe pozitën juridike të femrës në të. Në krahinat ku vepronin normat e të drejtës zakonore shqiptare celula bazë e shoqërisë ishte familja patriarkale²⁷. Familja patriarkale ishte një bashkësi njerëzish me lidhje gjaku në vijë të drejtë mashkullore ose të bashkuar në martesë. Brenda saj jetonin 2-3 breza. Kjo familje, kishte një ekonomi të përbashkët dhe degët kryesore të saj ishin bujqësia dhe blegtoaria. Burrat ishin bashkëpronar mbi pasurinë e familjes, ndërsa gratë nuk kishin pjesë në pasuri, pasi në derë të babës ato quheshin derë e huaj, ndërsa në derë të burrit ato ishin të ardhura dhe nuk sillnin pasuri me vete. Kështu, gratë ishin tërësisht të vendosura nën pushtetin ekonomik të burrave, duke minimizuar rolin ekonomik të tyre në familje tërësisht.

Pozita juridike e grave në familje dhe në jetën shoqërore në tërësi, përcaktohej nga roli i tyre në ekonominë familjare, duke i shmangur ato nga pronësia mbi pasurinë e përbashkët të familjes. Gratë dispononin vetëm sende të thjeshta vetjake, të përjashtuara nga pronësia dhe trashëgimia si në familjen e të atit edhe në atë të burrit.

Reformat ligjore në vite nuk kanë mjaftuar për të realizuar plotësisht të drejtat e grave për të poseduar dhe përdorur pronën. Përputhshmëria midis normave sociale me ligjet kombëtare kërkon ndryshime në nivel të popullsisë, ku mekanizmat e nevojshëm për veprim dhe përfitimet mund të identifikohen më lehtë. Iniciativat me bazë komunitare, si në mbarë botën, synojnë identifikimin dhe eliminimin e faktorëve apo arsyeve që ndalojnë gratë të përmbushin të

²⁵ Salvatore Villari, "Le Consuetudini giuridiche dell'Albania: Il kanun di Lek Dukagjin, Societa editrice del libre italiano, 1940

²⁶ Rustem Gjata, Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe rëndësia e tij në shoqërinë shqiptare <http://telegraf.al/drejtësia/dr-rustem-gjata-kanuni-i-leke-dukagjinit-dhe-rendesia-e-tij-ne-shoqerine-shqiptare>

²⁷ Aleks Luarasi, "Marrëdhëniet Familjare", SHB Luarasi, Tiranë 2001, fq. 11

drejtat e tyre. Këta faktorë në Kosovë përfshijnë mungesën e njohurive juridike për të drejtat ligjore midis grave në shoqëri, burimet e kufizuara të grave për tu informuar mbi dokumentacion (shpesh herë ato privohen nga informacioni mbi statusin e pronave të caktuara në mënyrë tejet arbitrare në organe të ndryshme të komunave e sidomos në krahinat jashtë Prishtinës²⁸), interpretimi i gabuar i ligjeve, ndryshimet ligjore që prekin regjimin e pronave dhe regjistrimin e tyre, si edhe nënshtrimi bazuar në mentalitetin zakonor, duke cuar deri në humbjen e mbrojtjes ligjore.

Rritja e ndërgjegjësimit dhe vëmendjes politike për të drejtat pronësore të grave ka rezultuar me krijimin e një kuadri ligjor, sikurse u përmend më lartë, i cili promovon në mënyrë progresive rëndësinë e zgjidhjes së këtij problemi.

²⁸ Shih më poshtë të dhënat mbi rastin e Afërdita Svatovcit

3. ZHVILLIMI HISTORIK DHE SFIDAT E TË DREJTAVE PRONËSORE TË GRAVE

Edhe në qoftë se një sistem ligjor parashikon qasje të barabartë në pasuri, gratë mund të përballen me vështirësi të mëdha në realizimin de jure të të drejtave të tyre pronësore, një pjesë e mirë për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit.

Ekziston një hendek i madh midis të drejtave pronësore të ligjëruara të grave dhe njohjes së tyre. Njohja e të drejtës së grave në pronë nuk ka qenë në qendër të pjesës së politikave më të rëndësishme në vende të caktuara²⁹, vite më parë ose të programeve që lidhen me tokën, strehimin dhe pronën martesore. Ndërkohë që disa vende i trajtojnë të drejtat pronësore si një çështje të të drejtave të njeriut, disa vende të tjerat kanë lejuar influencën e rregullave të tregut apo të drejtën zakonore për të përcaktuar se kush ka qasje në këto të drejta, ndërsa vende të tjera kombinojnë ndërhyrjen e shtetit me politikën e tregut. Kështu pabarazitë në pronësinë e tokës dhe të drejtat mbi pronën midis burrave dhe grave vazhdojnë të ekzistojnë në shkelje flagrante me detyrimet ndërkombëtare. Problematikat që identifikohen më së shumti janë:

Së pari, të drejtat e përgjithshme nuk janë përpunuar në mënyrë adekuate përmes ligjeve kombëtare dhe politikave të cilat mund të konvertojnë aspiratat në mekanizma praktike.

Së dyti, synimi për të arritur ose për të monitoruar sigurinë e posedimit, disponueshmërinë e shërbimeve dhe infrastrukturës, mundësitë e mirëmbajtjes, programet dhe politikën publike, investimet nuk janë zhvilluar plotësisht mbi bazën e programeve dhe planeve të detajuara.

Së treti, të drejtat e grave, veçanërisht të drejtat e pronësisë, kushtëzohen nga praktikën zakonore, pa njohjen e natyrës evolutive të këtyre të fundit.

Situata në vendet e Ballkanit është shumë e ngjashme, në zonat rurale ku cuditërisht perceptimi është aq i ngjashëm sa të krijoj përshtypjen e një stereotipi njerëzor të lindur. Pasuria e paluajtëshme është shpesh e regjistruar vetëm në emër të kryetarit të familjes, edhe në qoftë se gruaja ka sjellë pronën në familje ose e ka blerë atë nga të ardhurat e saj. Në shumë vende, gratë përjetojnë vështirësi në regjistrimin e pasurisë në emër të tyre dhe bashkeshortëve të tyre. Vetëm në disa vende si në Letoni dhe Lituani ku gratë mbajnë më shumë se 45%

²⁹ Institute for Habitat Development, Annual Report, 2003 Raporti është I aksesueshme në http://www.egug.co-plan.org/images/stories/publikime/pdf/annual_report/2003_Annual_Report.pdf
Shih edhe Konsolidimi I të Drejtave të Pasurisë në Sektorin e Ri të Fermave Private Te Shqipërisë, 1992

të të gjithë titujve të tokës ³⁰, pasuria regjistrohet në emër të të dz bashkeshortëve.

Nga studimi i hulumtive krahasimore të bëra rreth legjislacioneve të ndryshme në botë, konstatohet se tradicionalisht burrat dhe gratë kishin të drejta të barabarta për të mbartur pronë, por zakonisht ato regjistrohen sipas procedurave ligjore në emër vetëm të burrit³¹. Në përgjigje të këtij diskriminimi edhe në vendet më të zhvilluara, evoluimi i të drejtave ekonomike të grave drejtoi veprimtarinë e shumë faktorëve drejt zgjerimit të titullit të pronësisë nëpërmjet institutit të “posedimit të përbashkët” apo bashkësisë ligjore³² të pronës. Bashkësia ligjore supozon që nëse dy persona jetojnë së bashku, të drejtat e tyre mbi administrimin e pronës apo tjetërsimit të saj kërkojnë miratimin eksplicit të të dyve.

Ky përkufizim ligjor në këto vende u jep mundësinë edhe cifteve bashkëjetuese që përmes titujve të përbashkët të kenë të drejta të barabarta mbi pronën e fituar gjatë bashkëjetesës. Burim për këtë mendojmë se mund të jenë marrëveshjet e bashkëjetuesve ose ligji për ato bashkëjetesa, që kanë kaluar një periudhë qëndrueshmërie³³.

Të tilla praktika zbatohen në një numër të konsiderueshëm vendesh si Belgjikë, Bullgari, Francë, Itali, Holandë, Spanjë, Zvicër, Ukrainë, Rusi dhe Kroaci³⁴.

Kroacia u përzgjedh si një nga vendet e ish bllokut të Jugosllavisë e cila mbart elemente të vendeve të zhvilluar për nga historia, niveli i ulët i dëmeve me të cilat doli prej vendeve të Federatës ish Jugosllave, dinamikës së zhvillimit të shtetit ligjor pas viteve 2013 dhe antarësimit në Komunitetin European.

Deri përpara anëtarësimit në BE si rrjedhojë edhe të krizës nëpër të cilën kaloi, statusi i grave ishte përkeqësuar. Megjithë parashikimin e të drejtave themelore të grave problemet kryesore mbeteshin evidente. Femrat përbënin shumicën e të papunëve, ato ende fitonin më pak për të njëjtën punë, ato mbanin barrën e përkujdesjes për fëmijët, gratë ishin të nënpërfaqësuar në të gjitha nivelet e vendim-marrjes si në sektorin privat dhe publik; ngeleshin më të ekspozuara ndaj dhunës në familje, si dhe nuk gëzonin të drejtat në pronë në nivelet e dëshiruara. Pavarësisht kushteve të përgjithshme shoqërore, ky model mbetej i njëjtë në mesin e vendeve të Evropës post-komuniste.

³⁰ <https://www.giz.de/fachexpertise/downloads/giz2012-en-gender-and-access-to-land.pdf>

³¹ Policy makers guide to women's land, property and housing rights across the world, UN Habitat 2007, page 20- 25

³² Kjo formë e pasurimit të ërbashkët shpesh ngatërrohet me bashkëpronësiën e cila dallon në:

³³ Ky propozim del në kushtet e nevojës dhe paraprirjes së situatës, kur partneri bashkëjetues nuk do të pranonte nje marrëveshje të tillë në emër të pozitës që I jep tradita dhe mentaiteti shoqëror.

³⁴ Policy makers guide to women's land, property and housing rights across the world, UN Habitat 2007, faqe 22

Aktualisht Kroacia karakterizohet për një korpus ligjor të arrirë, Në Ballkan, për shembull, legjislacioni i pronës në Kroaci nuk përmban dispozita diskriminuese kundër grave duke reformuar në dy vitet e fundit dispozitatat për përdorimin e pasurisë martesore. Kroacia ka parashikuar dispozita të veçanta për tjetërsimin dhe transaksionet që lidhen me shtëpinë martesore, duke vendosur si kusht të domosdoshëm pëlqimin e bashkëshortit/es të shprehur me shkrim³⁵.

Gjithashtu bazuar në nenet 36 të Ligjit për familjen është përkufizuar qartësisht se çfarë përfaqëson pasuria martesore dhe të drejtat e barabarta në pjesë për të dy bashkëshortëve. Adminstrimi i zakonshëm i kësaj pasurie mund të bëhet duke prezumuar pëlqimin e bashkëshortit/es. Ndërkohë sikurse u përmend më sipër nëpërmjet nenit 32 të këtij ligji Kroacia ka nënvizuar garancitë ndaj bashkëshortëve lidhur me shtëpinë martesore.

Vlen të nënvizohet se Kroacia ka zgjidhur qartësisht, nëpërmjet dispozitatave problemin e pasurisë së fituar në bashkësinë faktike. Nëpërmjet parashikimeve të nenit 11 të Ligjit për familjen të këtij vendi, rregullohen efektet e bashkësisë faktike, e cila përkufizohet si marrëdhënia midis një gruaje dhe një burri të pamartuar që zgjat të paktën tre vjet ose më pak se tre vjet, nëse partnerët kanë fëmijë të përbashkët, si edhe në qoftë se marrëdhënia është pasuar në vijim nga martesë. Kjo bashkësi faktike gjeneron efekte personale dhe pronësore të njëjta me ato të një bashkësie martesore duke u bërë kështu objekt i dispozitave të ligjit për familjen. Pra, njohja e pasojave të njëjta personale dhe pasurore me ato të martesës është kushtëzuar nga kushtet që duhet të plotësojnë një lidhje faktike, për t'u barazuar me marrëdhëniet familjare që vijnë nga martesë. Kosova ka një zgjidhje ligjore të përafërt, por tepër të rëndë në kërkesat që parashikon për bashkëjetuesit.

Mbi të gjitha, Ligji për familjen në Kroaci, garanton ndalimin e diskriminimit të marrëdhënies në bashkësi faktike në paragrafin 3 duke parashikuar se *“Trajtimi i pabarabartë i atyre që bashkëjetojnë në lidhje me përfitimin e të ardhurave, të drejtave dhe detyrimeve që u jepen bashkëshortëve, nëse nuk janë të justifikueshme për arsye objektive dhe nuk janë të nevojshme për ushtrimin e tyre, përfaqëson diskriminim në bazë të statusit të familjes”*.

Prej analizimit të kujdesshëm të situatës ligjore në Shqipëri, ajo është sa e ngjashme aq edhe ndryshme me pozitat e lartpërmendura ligjore.

Së pari garantohen të drejtat pronësore të grave në martesë nëpërmjet parashikimeve të qarta të Kodit të Familjes të Republikës së Shqipërisë.

³⁵ Durđa Knežević, *Are Good Laës Enough? The Situation of Women in Croatia*, 2013

Së dyti situata ligjore e bashkësisë faktike apo bashkëjetesës sikundër përkufizohet në nenin 164 të KF përfaqëson një dispozitë të pamjaftueshmë për rregullimin e plotë të marrëdhënieve pasurore të bashkëjetuesve. Sipas tij “Personat bashkëjetues mund të lidhin marrëveshje para noterit, ku përcaktojnë pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës”. Parashikimi i mundësisë së rregullimit kontraktual të këtzre marrëdhënieve me një kontratë atipike dhe duke lënë të hapur rregullimin pa asnjë parashikim urdhërues ka krijuar efektet e një situatë thujse të pa rregulluar.

Për këtë lloj arsye niveli i ndërgjegjësimit për mungesën e pasojave pasurore nga bashkëjetesa është e lartë. Për këtë lloj arsye situata e cifteve në bashkësi faktike është perceptohet kryesisht si një fazë e jetesës para martesës dhe në këtë fazë të drejtat pasurore të secilit konsiderohen të bashkëjetuesit që ka kontribuar për përfitimin e tyre.

Të drejtat e trashëgimit në pronë nga gratë kanë evoluar në një zhvillim tepër të ngjashëm me atë të Kosovës, për shkak të mentalitetit të njëjtë dhe pozitave të gruas në shoqëri. Të shtyrë nga përfitimet në rritjen tepër dinamike të vlerës së pronave të paluajtshme, zhvillimit të sektorit të ndërtimit në vend (përftimi i pasurive të paluajtshme në këmbim të një prone së trashëguar për të gjithë fëmijët) dhe përhapjes së shpejtë të qasjes për përfitime pasurore, të cilat nuk cënojnë mirëqënien e anëtarëve të familjes kanë rritur numrin e grave që posedojnë patundshmëri. Tashmë femrat janë të ndërgjegjesuar për të drejtat trashëgimore. Sipas përpunimit të të dhënave nga Qendra e Kërkimit Monitor nga 600 kompanitë më të mëdha në vend, sipas qarkullimit vjetor, 50 prej tyre, janë të paktën 30% në pronësi të femrave

Fatkeqësisht, vazhdon i njëjti model perceptimi edhe në vitet e fundit kryesisht në zonat rurale duke e bërë gjendjen e grave të pafavorshme. Faktorët kryesorë që kanë kontribuar në këtë situatë janë njohuritë e kufizuara të grave mbi të drejtat e tyre të pronësisë, problematikat dhe mangësitë në legjislacion (siç është rasti i bashkëjetesës), pasaktësitë në praktikat gjyqësore dhe administrative, si dhe mungesa e monitorimit të zbatimit të ligjit për respektimin e barazisë gjinore³⁶.

Vërehen edhe pengesa burokratike prej organeve administrative të regjistrimit të patundshmërive apo lëshimit të certifikatave të pronësisë. Megjithë parashikimin e nenit 6837 të 8 të Ligjit 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”,

³⁶ Strategjia Ndërsektoriale Reforma Në Fushën E Të Drejtave Të Pronësisë 2012 - 2020

³⁷ Ky nen parashikon se, pronari ose personi që provon se ka interes legjitim, ka të drejtë të marrë të dhëna dhe kopje të dokumenteve, që janë në regjistrat e pasurive të paluajtshme,

nga praktika rezulton se punonjësit e ZRPP-së, nëse bashkëshortja nuk është e regjistruar si bashkëpronare, hezitojnë ta pajisin atë me kartelën e pronësisë, edhe pse në bazë të ligjit ajo prezumohet si bashkëpronare. Kjo ndodh pasi punonjësit e Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë mendojnë se kështu mund të shmangin ndonjë konflikt me bashkëshortin, në emrin e të cilit është regjistruar certifikata e pronësisë. Po kështu, ndodh që për pasuritë e paluajtshme të familjes bujqësore, për të cilat ende nuk është bërë regjistrimi fillestar, të drejtën për të marrë informacion mbi gjendjen juridike të pronësisë, e kanë vetëm kryetarët e familjes bujqësore. Anëtarëve të tjerë, nuk u jepet informacion mbi pasurinë³⁸.

Drejtimit ku nevojiten përmirësime janë: në legjislacion, rritje të aksesit të grave në institucionet për të drejtat e pronësisë, monitorimi i zbatimit të legjislacionit, trajnime të stafeve qendrore dhe lokale që merren me të drejtat e pronësisë, fushata sensibilizuese për informimin dhe promovimin e të drejtave të grave. Këto masa janë planifikuar edhe në përputhje edhe me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore e Dhunës në Familje dhe planin e saj të veprimit.

kartela, në harta kadastrale, në dokumentacione të depozituara me kërkesën për regjistrim dhe në dokumentacionin që mbahet e administrohet nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për të kërkuar informacion në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, duhet të kesh interes sipas ligjit, pra të jesh pronare, bashkëpronare (e prezumuar në rastin e bashkëshortes), të kesh një prokurë ose një vendim gjykate për hapjen e një procesi gjyqësor.

³⁸ Të drejtat pronësore dhe gruaja, Broshurë informuese, Tiranë, 2014

4. NJËANSHMËRIA MBI BAZË GJINORE DHE DOMINIMI NË PRONË

Rëndësia e të drejtave pronësore dhe ato trashëgimore të grave është formalizuar nëpërmjet njohjes së tyre në një shumëllojshmëri të instrumenteve ligjore ndërkombëtare. Sikurse u përmendën në analizën e kuadrit ligjor, në këto akte me theksin në Traktatet ndërkombëtare për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore si edhe për të Drejtat Civile dhe Politike, Platforma për Veprim të miratuar në Konferencën e Katërt Botërore për Gratë të vitit 1995, dhe Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave, nënvizohen të drejtat themelore që do të garantonin të drejtat pronësore.

Kështu, liritë dhe standartet jetësore, të cilat kanë në fokus të tyre të drejtat pronësore dhe çojnë drejt shfrytëzimit të së drejtës që një grua apo vajzë të posedojë pronë janë: liria nga cdo lloj diskriminimi; pavarësia financiare; liria e vendimarrjes për sipërmarrje ekonomike apo marrëdhënie pune, e drejta për të zotëruar, gëzuar apo tjetërsuar një pronë.

Shfrytëzimi në realitet i të drejtave të definuara në të drejtën pozitive përbën sfidën më të madhe, sidomos atëherë kur qeveritë i shohin shpesh normat ndërkombëtare si në kundërshtim me interesat e tyre dhe rezistojnë duke zbatuar të drejtat e përgjithësuara në sistemet e tyre sociale, ekonomike dhe kulturore. Përveç kësaj, edhe ratifikimi i një akti ndërkombëtar nuk do të thotë se dispozitat e tij bëhen të zbatueshme automatikisht në rendin juridik kombëtar³⁹.

Risollëm në vëmendje aspektin juridik të të drejtave pronësore për të vënë në dukje se garantimi i standarteve ligjore kur vihet përballë vështirësive si mungesa e ndërgjegjësimit dhe mekanizmave të papërshtatshme të zbatimit të së drejtave (aspekte materiale dhe procedurale të normave), atëherë përfitimi i të drejtave pronësore vonon ose mohoet. Për të mos përmendur rastet kur rregullimet ligjore nuk parashikojnë zgjidhjen e rrethanave jetësore, dominancës mashkullore apo vështirësive të veçanta me të cilat përballen gratë. Nëse do të

³⁹ Neni 19 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës- mbi zbatimin e së drejtës ndërkombëtare

1. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji.

2. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.

Në rastet kur qeveria ka kaluar ligje të cilat nuk parashikojnë tërësisht parimet e parashikuara në këto akte, për zbatimin e tyre dhe të ndryshimeve ligjore kërkohen përpjekje në më shumë nivele

zgjdhnim të rendisnim vetëm këto të fundit do të parashtronim efektet e problemeve ligjore të analizuara më sipër.

Përtej kësaj dhe nisur nga mundësia për të prekur reagimin nga rastet jetësore të grave vendosëm të parashtrijmë faktorë, të cilët i konsiderojmë njëherësh problematikë dhe zgjidhje për të ardhmen e grave dhe vajzave të Kosovës.

4.1 Edukimi dhe ngritja e nivelit të informimit mbi të drejtat pronësore dhe përfitimin e tyre

Përbën një fakt të pakontestueshëm se në zhvillimin historik të shoqërive, të drejtat janë përcaktuar në varësi të statusit brenda në familje dhe të përmbushjes së nevojave jetësore në të. Kombinimi i proceseve të industrializimit dhe globalizimit ndryshoi njëherazi sistemet e prodhimit duke i detyruar familjet të fokusohen më shumë në aktivitete të gjenerimit të të ardhurave sesa në praktikën e mbijetesës⁴⁰. Faktori kryesor që ndikoi në rritjen e angazhimit dhe kontributit të grave ishte rritja e nivelit të tyre të edukimit dhe mbi të gjitha informimi real mbi atë cka kanë të drejtë të kryejnë dhe posedojnë. Efekti do të ishte i prekshëm në rritjen e pavarësisë së grave, angazhimit më të madh në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, rritje e nivelit të mirëqënies së tyre ekonomike e njëherazi të mirëqënies së tyre psikologjike⁴¹ dhe sociale.

Edukimi i grave dhe vajzave në kontekstin e informimit tërësor të të drejtave pronësore dhe mënyrës së pretendimit dhe kërkesës për ti disponuar këto të fundit në vendet ku ndonëse ka një kohë kaq të gjatë që sundon e drejta pozitive, përbën jo vetëm një faktor thelbësor, por edhe një vështirësi jo lehtësisht të kapërcyeshme. Pikërisht nëpërmjet ideologjisë së rrënjosur në familje të instituteve të së drejtës zakonore, ndërmarrja e aksioneve (në forma të ndryshme) të çrrënjosjes së tyre është e vështirë, me impakt të ngadaltë dhe me nevojën kyçe të ndërveprimit nga shoqëria edhe nga përfaqësuesit e institucioneve.

Një prej pikave kyçe në promovimin e të drejtave pronësore dhe trashëgimore të grave është që tendencat e zhvillimeve në shoqëri duhet të shtrihen edhe në këtë drejtim, duke zhvendosur normat sociale dhe traditat me zbatimin në mënyrë të drejtë të ligjeve dhe akteve nënligjore të fushës.

⁴⁰ Groën, Caren; Gupta, Geeta Rao; Kes, Aslihan, Taking action achieving gender equality and empowering women (Task Force on Education and Gender Equality), ISBN 1844072223 London Sterling (2005).

⁴¹ Për më tepër, përfitimet psikologjike si rezultat i rritjes së të drejtave pronësore të grave do të çonte edhe në zvogëlimin e nivelit të dhunës në familje sipas studjueses Bina Agarwal, të Institutit për Zhvillim Ekonomik të Universitetit të Delhit në Indi.

Kushtet që do të favorizonin këto procese janë në dy nivele. Së pari në drejtim të arsimimit dhe infomimit të plotë të grave për të drejtat që posedojnë. Dhe së dyti krijimi i klimës së përshatshme nëpërmjet vendimarrjes dhe garancive gjyqësore, të cilat do të trajtohen në mënyrë më të detajuar në vijim.

Edukimi si mënyrë ndërveprimi ndaj gjendjes së krijuar në drejtim të drejtave pronësore të grave mund të realizohet nëpërmjet mekanizmave dhe objektivave të analizuar më poshtë:

4.1.1 Ndërgjegjësimi i grave për pasojat e vendimarrjes së tyre në të ardhmen

Mobilizimi i aktorëve që punojnë prej vitesh në Kosovë në drejtim të informimit publik dhe evidentimit të pengesave të drejtave pronësore të grave nëpërmjet veprimtarive informuese dhe edukuese. Këta aktorë mbështeten fort nga organizma ndërkombëtarë, të cilët kanë ndikuar pozitivisht në këtë drejtim, megjithatë mendojmë se koordinimi dhe alternimi i veprimtarive, hulumtimeve dhe ndihmës juridike, do të rriste efektet e dëshiruara.

Realizimi i kampanjave informuese mund të kenë si objekt parimet e barazisë në shoqëri, mbrojtjen që garanton ligji dhe mënyrën sesi një grua mund të kërkojë të drejtën e saj. Kampanjat e infomimit realizohen nëpërmjet mjeteve të komunikimit masiv si kampanjat radiofonike, në televizion, shfaqjeve artistike që mund të realizohen në sheshe të Komunave të Kosovës apo shpërndarjes së broshurave të detajuara për infomim⁴².

Vendet të cilat në zhvillimin e tyre historik kanë kaluar nëpër këto problematika kanë filluar me të tilla arritje me qëllimin e vetëm në ndryshimin e qëndrimit dhe sjelljes së grave për këto të drejta. Në fund të fundit cdo gjë fillon prej tyre.

Me anë të qëllimit për të informuar këtë pjesë të prekur të shoqërisë synohet gjithashtu të garantohet që gratë e brezave të reja janë më të informuara mbi të drejtat e tyre dhe mund të jetojnë si të barabarta nën mbrojtjen e ligjit. Këto praktika kanë rezultuar edhe më të suksesshme në rastet kur në mënyrë të vazhdueshme në këto kampanja informimi dhe edukimi të grave përfshihen meshkujt. Përfshirja e tyre si në rolin e trajnuesve përcon tek femrat mendimin se jo të gjithë meshkujt në shoqëri i mohojnë të drejtat pronësore. Gjithashtu nëse një gruaje i mohohen këto të drejta në familjen e saj, kjo është arsye për të parë një realitet tjetër dhe dimension të respektimit të gruas nga një familje në një tjetër.

⁴² Model i një broshure informuese të botuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare me të njejtin qëllim në Shqipëri me mbështetjen United Nations Entity for Gender Equality dhe UN Albania. Të drejtat pronësore dhe gruaje, Broshurë informuese, Tiranë, 2014

Shqipëria ka bërë një progres të ndjeshëm vitet e fundit në drejtim të garantimit të të drejtave pronësore. Analizimi i hulumtimeve të kryera në këtë fushë të krijon idenë se rruga që ka përshkruar ka pasur në fokus të njëjtat problematika e mbi të gjitha influencën e madhe të së drejtës zakonore.

Hulumtimet dhe aktivitetet e ndërmarra për ndërgjegjësimin dhe edukimin e grave për të drejtat pronësore kanë pasur edhe një fokus shumë të veçantë, atë të ndërgjegjësimin nën perspektivën e ndryshimeve ekonomike në vend. Kështu në luftën kundër instrumentit të heqjes dorë nga trashëgimia gratë janë informuar mbi të drejtat e tyre në këndvështrimin e ndryshimeve që mund të ndodhin në të ardhmen. “Mendohuni mirë përpara se të vendosni të hiqni dorë nga trashëgimia. Vlera e pasurisë jo vetëm ndryshon me kalimin e kohës, por edhe shfrytëzimi i saj në kushtet e ekonomisë së tregut mund të sjellë përfitime të paparashikuara. Kështu, psh., ju jeni trashëgimtare e prindërve, mbi shtëpinë ku aktualisht banon vëllai juaj, i cili gjithashtu, është trashëgimtar i tyre. Ju dëshironi të hiqni dorë nga pjesa e shtëpisë që trashëgoni, me qëllim që vëllai juaj ta gëzojë shtëpinë me gruan dhe fëmijët e tij. Në këtë rast, ju humbni të gjitha të drejtat tuaja që burojnë nga kjo pronë. Prandaj, nëse më tej, trashëgimtari i vetëm, vëllai juaj, vendos të prishë shtëpinë me qëllim që në atë tokë të ndërtohet një pallat këtë të drejtë e ka vetëm ai. Veç kësaj nga apartamentet do të përfitojë vetëm ai. Ju nuk mund të kërkonit këtë të drejtë në bazë të ligjit sepse keni hequr dorë nga pasuria”⁴³

4.1.2 Zgjerimi i njohurive dhe aftësive të grave të zgjedhura në nivel lokal

Kjo pikë përfaqëson një mekanizëm me impakt të lartë që ka për synim rritjen e nivelit të informimit dhe edukimit mbi kuadrin ligjor të të drejtave pronësore të grave, për të lobuar më pas në nivele të ndryshme të vendimarrjes për çështjet e pronësisë dhe të trashëgimisë së grave. Informimi dhe trajnimi i grave të zgjedhura në nivel lokal mbi të gjitha rreth zbrazëtimeve ligjore dhe abuzimeve do të rriste nivelin e tyre të informimit, në mënyrë që ata do të jenë në gjendje për të të promovojnë vetëdijen dhe veprimet mbi çështjet dhe ligjet që i përkasin të drejtave pronësore dhe trashëgimore.

4.1.3 Rritja e nivelit të ndërgjegjësimin në nivel lokal.

⁴³ Qendra për nisma ligjore qytetare, Të drejtat pronësore dhe gruaja, Broshurë informuese, Tiranë, 2014, fq.11

Me këtë pikë kemi parasysh jo vetëm zgjerimin edhe frekuencën e ndërveprimit për të kuptuar standartin ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi në të drejtat pronësore, por mbi të gjitha promovimin e informacionit në mënyrë sa më konkrete, të thjeshtë dhe mundëssht nëpërmjet figurave publike në lokacionet përkatëse që gëzojnë reputacion pozitiv. Kështu, evidentimi i nevojave dhe përfitimeve në çështjet pronësore për gratë është më lehtë për t'u kuptuar dhe adresuar. Një mënyrë e mirë janë konsideruar edhe zhvillimi i programeve radifonike kryesisht në radio lokale, nëpërmjet të cilave të zgjerohen njohuritë që duhet të kenë gratë për të drejtat pronësore. Kjo përsëri është një nga mënyrat për të rritur vëmëndjen e grave për kujdesin që duhet të shfaqin në momente thelbësore të vendimarrjes së tyre. Nga praktikat e zbatuara në mënyrë të ngjashe në botë⁴⁴ të tilla informime publike ju drejtohen grave edhe në formën e “tërheqjes së vëmëndjes” mbi thirrje⁴⁵ si :

- Mos firmos kurrë në një fletë të bardhë;
- Mos nxito të firmosësh asnjë dokument pa e lexuar atë me kujdes;
- Bëji pyetje personit që kërkon të firmosësh diçka dhe syno që të sqarosh çdo paqartësi;
- Denonco menjëherë nëse ke firmosur nën presion, kërcënim, frikë dhe mashtrim;
- Mos hiq dorë nga të drejtat e tua pa kuptuar se për çfarë po heq dorë;
- Pyet dikë që njeh ligjin dhe di më shumë në këtë fushë;
- Drejtohu Klinikës për ndihmë juridike falas apo një avokati; etj

Kampanjat dhe aktivitetet në nivel lokal shpesh kanë përhapje më të gjerë sesa në qytetet e mëdha, duke ndikuar më shpejtë në nivelin e informimit dhe pse jo edhe të raportimit të mohimit dhe/ose cënimit të së drejtës.

4.1.4 Avokimi dhe ofrimi i ndihmës juridike falas

Ofrimi i ndihmës juridike falas është një aktivitet i rregulluar me ligj në Republikën e Kosovës. Aktiviteti i zhvilluar në Klinikën Juridike mundëson qytetarëve me mjete të pamjaftueshme financiare të kuptojnë të drejtat e tyre dhe mënyrën sesi mund ti mbrojnë. Kjo do tu shërbentë grave dhe vajzave për të kuptuar gjuhën teknike të ligjeve, që rregullojnë të drejtat pronësore. Ndihma juridike falas, mund të përfshijë:

⁴⁴ Brochure on `omen's Property Rights In Kosovo “Do Not Remain Silent”, IGJK dhe UN `Eomen, Prishtinë 2013

⁴⁵

- informacion dhe këshilla ligjore lidhur me drejtat pronësore dhe trashëgimore;
- hartimin e aktit dhe ofrimi i ndihmës tjetër teknike që ka të bëjë me paraqitjen e një ankese dhe/ose përfundimin e një çështjeje;
- përfaqësimin në shqyrtimin e rasteve civile apo administrative me objekt të drejtat pronësore dhe trashëgimore;
- informacion dhe këshilla ligjore lidhur me procedurat për Ndihmë Juridike Falas.

Një ndër risitë e punës me këtë mekanizëm kaq human dhe frytdhënës është edhe keshillimi juridik, duke përfshirë edhe sqarimin e grave mbi legjislacionin e kësaj fushe, nepermjet mjeteve të telekomunikacionit dhe mjeteve elektronike të komunikimit.⁴⁶

4.1.5 Ndërveprimi nëpërmjet universiteteve.

Të drejtat pronësore në jetën familjare dhe në atë në çift çon në kultivimin, garantimin dhe respektimin e këtyre standardeve në një prej qelizave bazë të shoqërisë, siç është familja. Edukimi mbi të drejtat pronësore mund të krijë një bazë të sigurtë për ndryshimin e perceptimit të këtyre çështjeve dhe pozicionimit të grave dhe vajzave tek brezat e ardhshëm. Kjo mund të realizohet nëpërmjet ligjeratave të veçanta mbi këtë temë, apo edhe zhvillimin e gjyqeve simuluese kryesisht në fakultetet juridike në vend. Kështu të rinjtë jo vetëm edukohen me këto nocione, por i përcjellin ato në mënyrë më bashkëkohore tek bashkëmoshatarët.

Gjithashtu institucionet e arsimit të lartë mund të ndërveprojnë me sukses në këtë pikë edhe nëpërmjet realizimit të hulumtimeve në nivel individual apo në grup nga stafet akademike, specialistë të fushave, me fokus analiyimin e qëndrimeve, nivelin e informimit dhe vetëdijes për të drejtat pronësore që kanë gratë, si edhe nëpërmjet nxitjes së debateve publike mbi këtë tematikë.

4.1.6 Ndërmjetësimi

Së fundi, po e rëndësishme për t'u nënvizuar është edhe aktiviteti i ndërmejtësve në vend. Ndërmjetësimi është aktivitet i zhvilluar jashtë gjykatës, që në përputhje me kërkesat ligjore, synon zgjidhjen e një rasti nëpërmjet një pale të

⁴⁶ Copyright (c) 1998 Buffalo Women's Law Journal
Buffalo Women's Law Journal, International Column: The Legal Status of Women in Croatia: A Report on the Activities of Legaline, A Telephone Service Providing Legal Advice to Women

tretë neutrale. Ndërmjetësimi është një nga ndërhyrjet për të ndihmuar të hynë në drejtësinë në një mënyrë më pak të kushtueshme. Në shumicën e rrethanave, ajo është përdorur si opsioni i parë për gratë për ti mbrojtur në realizimin e të drejtave të tyre pronësore.⁴⁷ Referuar “Studimit bazë në nivelin nacional mbi të drejtat pronësore në Kosovë” të përgatitur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, rezultoi se nga shqyrtimi i proceseve gjyqësore në tre gjykata të shkallës së parë në Kosovë, disa gjykata hezitojnë dhe i shmangen shqyrtimit të rasteve jo kontestimore të trashëgimisë, duke insistuar që ato të shqyrtohen nga noterët. Në kushtet e konfuzionit dhe tarifave jo të ulta të shërbimeve noteriale evidente shpesh familjet në zonat rurale⁴⁸ apo ato në pamundësi financiare zgjedhin të mos ndjekin procedurën formale për të ndarë një pasuri e rrjedhimisht për të transferuar “de cujus-in” tek trashëgimtarët (pasuria rrjedhimisht ngelet në emër të personave të vdekur). Në këtë mënyrë paraqitet një zgjidhje shqyrtimi i këtyre rasteve nëpërmjet ndërmjetësimit. Për më tepër në bllokadën që u paraqitet grave nëpërmjet mentalitetit, informimi dhe shqyrtimi i një rasti tek ndërmjetësi do të ulte dozën e zyrtarizimit dhe peshës që ndjen një grua që pretendon të drejtat e saj pronësore në gjykatë.

4.2 Përmirësimi i Klimës Shoqërore dhe Institucionale për Mbështetjen e Grave në këtë Sfidë

Diskriminimi është i realizuar në mënyrë kaq tinzare dhe të fshehtë sa që, çështjet e trajtuara duhen analizuar jo bukvalisht, por nga filozofia që përcjellin, apo edhe për nga pasojat që mund të sjellin. Në këtë mënyrë, mund të themi se çdo profesionist ndjen brenda vetes se ka arritur në thelb të njohjes dhe zgjidhjes së problemeve, për të cilat ai mund të kontribuojë në ushtrimin me etikë të profesionit. Përmirësimi i klimës shoqërore dhe institucionale për mbështetjen e grave në këtë sfidë ligjore dhe sociale e konsiderojmë si pikënisjen e zhvillimeve pozitive për realizimin e të drejtave pronësore. Ky dimension do të përmbushej në kushtet e garantimit të standarteve të analizuara në vijim:

⁴⁷ Florence Chagadama, A Critical Examination Of The Use Of Mediation As A Tool For The Realisation Of Women's Access To Justice In Property Cases In The Legal Aid Sector, Zimbabëe, 2014

Studimi është i aksesueshëm në adresën

http://ir.uz.ac.zë/bitstream/handle/10646/2596/Chigadama_A_Critical_Examination_of_The_Use_Of_Mediation.pdf?sequence=3

⁴⁸ E Drejta e Trashëgimisë Pronësore të Grave në Kosovë, botuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Prishtinë 2011

4.2.1 Përputhshmërisë midis kuadrit ligjor dhe mekanizmave të zbatimit praktik të tyre

Rritja e ndërgjegjësimit dhe vëmendjes në vendimarrjet politike dhe ligjore mbi të drejtat pronësore të grave ka rezultuar me aprovimin e ligjeve progresive që parimisht promovojnë dhe mbrojnë këto të drejta. Por shumë shpesh, hendeku midis akteve ligjore dhe praktikës aktuale theksohet. Gratë përballen me sfida serioze në përmbushjen e të drejtave të tyre, kur ligji bie në kundërshtim me normat shoqërore, ligji zbatohet në nivel të ulët .

Dinamika e mëdha sociale dhe ekonomike nxjerrin më në pah mungesën e proporcionalitetit midis të drejtave të garantuara dhe zbatimit të tyre në praktikë.

Reformat ligjore dhe politike nuk janë të mjaftueshme për gratë për të realizuar plotësisht të drejtat e tyre të posedojnë dhe përdorin pronën. Pajtimi midis normave zakonore dhe ligjet e vendit kërkojnë ndryshime në nivel lokal.

Në mbarë botën, iniciativat me bazë komunitare janë përpjekur për të identifikuar dhe për të eliminuar faktorët që pengojnë gratë nga përfitimi dhe gëzimi i të drejtave të tyre. Këta faktorë përfshijnë mungesën e njohurive juridike për të drejtat ligjore të grave të analizuara më sipër, burimet e kufizuara financiare të grave për të ndjekur këto çështje, dokumentacioni jo gjithnjë i disponueshëm si në famije ashtu edhe në formën e burokracive institucionale, interpretimi i gabuar i normave ligjore që në praktikë anulojnë nuk garantojnë mbrojtjen e paraparë me ligj, dhe unifikimi i sistemit kadastral i regjistrimit të pronës.

Në kushtet kur të gjitha strategjitë e qeverisë në vend synojnë të balancojnë perspektivat moderne dhe tradicionale në vend, mendimi ynë është se ndërveprimi për zgjidhjen e këtij faktori mund të jënë dy drejtime të rëndësishme që do të shtrin efektin pozitiv edhe në dimensione të tjera të zhvillimeve në vend.

4.2.2 Ngritja dhe forcimi profesional i kapaciteteve njërëzore në vend.

Ndërveprimi në drejtim të ngirtjes së kapaciteteve, e mbi të gjitha të forcimit profesional të tyre në vend mund të konsiderohet *si aftësimi për të ardhmen*. Mbështetja e kapaciteteve të të rinjve (sidomos atyre në drejtimin juridik) dhe trajnimi i burimeve njërëzore në nivele të ndryshëm institucionale që merren me të drejtat pronësore të grave është një proces transformues, i cili ka për qëllim të ofrojë njohuritë, teknikat dhe mjetet për të zhvilluar aftësitë dhe qëndrimet ndaj këtij problemi shoqëror. Ajo është një proces i vazhdueshëm dhe afatgjatë që kërkon mbështetje politike dhe angazhimin e të gjitha aktorëve që mund të

ndikojnë në veprimtarinë e tyre për të realizuar të drejtat pronësore dhe trashëgimore të grave.

Inkurajimin i të rinjve për të ndërtuar njohuritë dhe zhvilluar aftësitë e tyre në veprimtari praktike siç është edhe objekti i klinikave për ndihmë juridike, organizatave joqeveritare, do të siguronin një brez juristësh apo zyrtarësh të aftë të ushtrojnë me integritet përgjegjësitë që u ngarkohen. Ajo që është edhe më e rëndësishme trajnimi i burimeve njerëzore në gjykata, ushtrues të lirë të profesionit, si edhe administratës publike minimalisht do të ulte nivelin e indeferencës dhe rriste ndjenjën e mobilizimit kolektiv për të drejtat pronësore të grave. Normalisht fokusi është shmangia e zbatimit të praktikave të dyfishta, keqinterpretimeve të ligjeve dhe uljen e nivelit të burokracisë në përbushjen e detyrimeve të tyre. Për gratë kjo do të përkthehej në rritje të besimit se do të përfitojnë të drejtat që u takojnë dhe rritjen e rasteve kur gratë pretendojnë realizimin e ketyre të drejtave pronësore.

4.2.3 Mbështetja e hulumtimit shkencor

Rëndësia e hulumtimit në cdo fushë të jetës është ngritja e njohurive bazë dhe identifikimin e metodave më të mira për zhvillim në aspekte të ndryshme të jetës në shoqëri. Sikurse u përmend disa herë në rrjedhën e trajtimit të çështjeve të mësipërme, një nga pengesat bazë në drejtim të të drejtave pronësore të grave ngelet besimi ende i madh tek normat patriakale dhe rrjedhimisht vështirësia për ti çmontuar ose modifikuar këto të fundit. Për këtë arsye zhvillimi i hulumtimeve shkencore mbi praktikën ndërkombëtare, studet e zhvillimit historik të të drejtave pronësore të grave në botë, në rajon e kryesisht në Kosovë, apo edhe hulumtimi i praktikave negative, pozitive dhe negative, do të kontribuonte në:

- vlerësimin e impaktit të reformave në vend;
- rekomandime mbi politikën më të mira në nivel qendror dhe lokal;
- analizimin e ndryshimeve të vazhdueshme në kuadrin ligjor dhe nënligjor,
- evidentimin e mekanizmave konkretë për zgjidhjen e problematikave praktike. Kjo normalisht do të rriste numrin e studimeve në vend dhe zgjerimin e lobimit nëpërmjet qarqeve intelektuale në vend.

4.3 Realizimi i garancive procedurale

Kemi zgjedhur të ndalemi në një mekanizëm të rëndësishëm të garantimit të të drejtave pronësore të grave të kontestuara, si detyrimi i organeve shtetërore për të mos cënuar të drejtat dhe liritë e shtetasve në realizimin e tyre ose mos lejuar cënimin e tyre nga subjekte të tjera.

Duke marr shkas nga numri i madh i çështjeve të shqyrtuara nga CLARD dhe Klinika për ndihmë juridike falas, është evidente se rastet më të shumta objekt i të drejtave pronësore të grave, nuk janë në formën e këshillimit dhe informimit për të drejtat pronësore. E kundërta, rastet e shqyrtuara kanë në thelb kontestin e të drejtës së grave. Kontestimi i të drejtës së pronës së një gruaje patjetër që do të kishte dy mundësi; dorëzimin e saj dhe humbjen e besimit se ndonjeherë do të mund t'ja dal në luftën kundër paragjyqimeve se asaj nuk i takon asgjë përsa kohë nuk ka kontribuar në para dhe karvanit të gjatë të proceseve gjyqësore të shoqëruar me mungesën e mbështetjes nga familja; ose vendosmërinë e një gruaje që beson se të drejtat janë për t'u përfituar, pa hequr dorë prej tyre.

Përvec garancive që siguron dispozitivi i një norme në përcaktimin e të drejtës për një subjekt, kjo e drejtë nuk do të merrte asnjëherë formë nëse nuk regjistrohej në emër të titullarit të së drejtës. Ndërsa në rastet kur kjo e drejtë kontestohet, realizimi i saj do të varet nga procesi i rregullt ligjor, si një karakteristikë e shtetit të së drejtës.

Një rast në fashtin Sllatinë e Madhe, i ngritur më 27 shkurt 2006, me objekt përcaktimin e të drejtës së patundshmërisë dhe bartjes e saj nga shtetasja Aferdita Statovci. Padiësja është pasardhëse e vetme ligjore dhe njëherazi trashëgimtare e rradhës së parë e të atit R. Statovci (e dëbuar me të emën nga shtëpia e përbashkët pas vdekjes së të atit), dhe kërkon bartjen e pronësisë për patundshmëri dhe regjistrimin e pronës, bazuar në kontratën e shkruar midis blerësve (një prej të cilëve është i ati i padiësës) dhe të paditurit.

Gjykata kishte konfirmuar pohimin e padiësit për pronësi në bazë të provave për përfitimin e pronës së pretenduar, posedimit faktik nga familja e saj mbi 30 vite dhe statusit të trashëgimtares ligjore. Megjithë pasqyrën reaktivisht të qartë, gjykimit me Aktvendim të formës së prerë e më pas rishqyrtimeve “ping – pong” të gjykatave, burokracive dhe pretendimeve të pabazuara të trashëgimtarëve të tjerë, ajo ngelet në 11 vite, ende një lëndë e pagjykuar.

Për të ilustruar probleme të përafërta, të cilat konstatohen në praktikën e gjykatave të ndryshme kemi përzgjedhur një rast të thjeshtë në dukje, por që ende nuk ka marrë epitetin e gjësë së gjykuar, e për rrjedhojë ngelet një e drejtë e pashfrytëzuar.

Rasti i pasqyruar shkurtimisht shpalos problematika sa ligjore aq edhe frymën dekurajuese të institucioneve administrative e mbi të gjitha të gjykatave. Kjo padyshim do të krijonte një klimë të pafavorshme për çdo grua që do të ndiqte të drejtën e saj për të bartur pronë. Deri më tani është përmendur shpesh sesi gratë në Kosovë në mënyrë të heshtur përjashtohen nga e drejta e tyre për të trashëguar apo shmangen nga përfitimi i të drejtave pronësore në familje. Ndërkohë edhe në rastet e grave të vendosura për të kërkuar të drejtën e tyre, ato rëndom nuk mbështeten. Për më tepër bëhen peng të një sistemi gjyqësor të mbushur me shkelje të rënda kushtetuese e procedurale.

Rasti i Afërditës shpalos dimensionin e kundërshtimit prej trashëgimtarve meshkuj për të përfituar pronën në masën që i takon, me argumente të cilat shprehin patriarkalitetin e tyre.

Në këtë mënyrë prishja e vendimit të formës së prerë është bërë duke vënë në situatë krejtësisht të pafavorshme palën në favor të së cilës ishte dhënë vendimi (Znj. Aferdita Svatovci) dhe duke cënuar ekuilibrin që duhet të kenë ato në proces.

E drejta për të trashëguar pjesën e të atit në pronën e përbashkët të xhaxhait të saj dhe të të ndjerit, bazohet në një nga mënyrat e parapara për të fituar pronësi në Ligjin për marrëdhëniet themelore juridike pronësore.⁴⁹ Kjo e drejtë e Afërditës kontestohet nga kushëriri i parë si bartës i pronës së babait të tij, e për ironi pretendon mohimin e së njëjtës së drejtë, tanimë nga një trashëgimtare e të njëjtit rang, por e gjinisë femërore.

Garancitë kushtetuese për një proces të rregullt e të paanshëm⁵⁰ dhe mbrojtjes së barabartë ligjore e pa diskriminim⁵¹ përbëjnë themelet për mbrojtjen e cdo të drejte të kontestuar në një shtet ligjor e demokratik. Këto të drejtat dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁵², të cilat përbëjnë një konfirmim të mënyrës sesi shtetasit e Kosovës duhet të gjykohen dhe trajtohen.

⁴⁹ Bazuar në Nenin 20 të Ligjit, e drejta e pronësisë fitohet sipas ligjit, në bazë të veprimt juridik dhe me trashëgimi.

⁵⁰ Shih Neni 31/1 I Kushtetutës së Republikës së Kosovës. “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”.

⁵¹ Shih neni 24 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës “. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim”

Bazuar në nenin 6 të KEDNJ, vlen të theksohet se e drejta për një proces të rregullt zë një vend të rëndësishëm në një shoqëri demokratike, në kuptimin e Konventës. Rëndësia e saj duhet parë në kontekstin e funksionimit të demokracisë dhe për këtë arsye interpretimi i saj duhet të jetë sa më i gjerë. Në vendimin e saj për çështjen Delcourt kundër Belgjikës, Gjykata theksoi se “në shoqërinë demokratike, në kuptimin e Konventës, e drejta për një proces të rregullt ligjor zë një vend kaq të rëndësishëm, sa që interpretimi i ngushtë i nenit 6/1 nuk do t’i përgjigjej as qëllimit dhe as karakterit të këtij neni”. Sipas saj, neni 6 duhet të interpretohet gjithashtu duke mbajtur parasysh parimet e përgjithshme të së drejtës, të pranuar nga kombet e civilizuar, duke përfshirë këtu parimin se gjithkush duhet të ketë mundësinë t’i parashtrojë gjykatës çështjen e tij si dhe një parim tjetër nga i cili buron ndalimi për të refuzuar dhënien e drejtësisë.

Përfundimet rreth shqyrtimit të këtij rasti reflektojnë qartazi edhe cënimin e parimeve të çështjes së gjykuar dhe ezaurimit të mjeteve ligjore nga subjektete në kohë. Parimi i çështjes së gjykuar reflekton qëndron i lidhur në mënyrë korrelative me parimin e sigurisë juridike, që u garantohet individëve në cdo shoqëri. Nën mbulesën e “korrigjimit të aktevevendimit”, çështja e lartpërmendur ka marr një herë statusin e Aktvendimit të formës së prerë dhe pas kësaj është kthyer për rishqyrtim, megjithë rrjedhjen e afateve për ankimim. Rishqyrtimi i çështjes nga Gjykatat dhe hapja e një kalvari të gjatë seancash na jep arsye të përkufizojmë demoralizimin e grave në shoqëri për të pretenduar të drejtën e tyre.

Për më tepër një tjetër problem i konstatuar jo vetëm në këtë rast, gjatë shqyrtimeve procedurale, është zgjatja e tyre në kushtet e pengesave apo burokracive për të mbështetur pretendueset e gjinise femërore të nxjerrin Aktin e trashëgimisë.

Në kushtet e nismave reformuese, mbështetjes së shprehur publikisht prej organeve të pushtetit ekzekutiv në vend dhe ndihmës së ofruar nga aktorë të ndryshëm që veprojnë në Kosovë, fokusi duhet të jetë edhe në kontrollin e veprimtarisë së Gjykatave dhe organeve që mbështesin mbledhjen e provave në një proces.

Nëpërmjet kësaj, natyrshëm klima e garantimit të të drejtave pronësore do të bëhej më inkurajuese dhe mbi të gjitha e përshtatshme për një vend demokratik si Kosova.

PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton qartësisht rol të barabartë e grave dhe burrave në shoqëri, duke përjashtuar cdo mundësi diskriminimi si vlerë themelore e sanksionuar nëpërmjet legjislacionit të bredshëm të veçantë dhe ratifikimin e konventave ndërkombëtare të përmendura në të.
2. Akte ligjore që rregulojnë të drejtat pronësore dhe trashëgimore kanë formalizuar një sistem të ndërlikuar rregullash, i cili krijon shpesh herë hapësira për keqinterpretime, deformime apo edhe shmangie e qëllimshmë prej synimit të ligjvënësit.
3. Ekzistenca e një hendeku midis akteve ligjore dhe praktikës aktuale, i cili vazhdon të theksohet. Gratë përballen me sfida serioze në përmbushjen e të drejtave të tyre, kur ligji bie në kundërshtim me normat shoqërore apo zakonore.
4. Pengesa bazë në drejtim të të drejtave pronësore të grave ngelet besimi ende i madh tek normat patriakale dhe rrjedhimisht vështirësia për ti çmontuar ose modifikuar këto të fundit
5. Konsiderojmë se kuadri ligjor për rregullimin e marrëdhënieve familjare dhe ai mbi të drejtën e trashëgimit paraqet kushte përjashtuese nga e drejta për të trashëguar për personat që janë në bashkësi jashtëmartesore, në rast se njëri prej tyre vdes. Meqënëse fokusi i këtij studimi janë gratë dhe ato paraqiten në nivel shumë të ulët si zotëruese të pronave, ngelet të kuptohet që këto rregullime cënojnë drejtëpërdrejtë dhe në mënyrë disfavorizuese gratë në Kosovë. Përjashtimi nga e drejta për të trashëguar në rastet e bashkësive faktike përfaqëson një pjesë të konsiderueshme të grave të cilat gjenden në kushtet e mungesave të burimeve financiare apo minimalisht të shtëpisë së banimit, pra në mëshirën e fatit dhe humanitetit të familjarëve.
6. Pretendimet e hasuara në praktikë për të evituar gratë prej pasurisë së përbashkët martesore me argumentin e ngushtë për mungesë të kontributit financiar, thekson nevojën për:
 - të nënvizuar barazinë midis kontributit financiar dhe atij në natyrë për mbarëvajtjen e familjes dhe

- të shmangur mundësinë e lënë në pikën 4 të nenit 47 të Ligjit për familjen, për mundësinë e marrëveshjes midis bashkëshortëve për të pasur pjesë të barabarta në pasuri.

3. Rekomandohet ndryshimi i Ligjit për familjen dhe Ligjit për trashëgiminë në Kosovë, si në aspektin e saktësisë dhe qartësisë terminologjike të parashikimeve, ashtu edhe balancimin midis kushteve për të njohur bashkësitë faktike dhe pasojave legjitime të burrit dhe gruas që jetojnë në çift.

4. Ekzistenca e nevojës për inkurajimin e çifteve të martuar sipas dokeve fetare e zakonore apo që janë në premtim për martesë të shkojnë drejt formalizimit të jetës në çift nëpërmjet lehtësimeve të caktuara për çiftet që tashmë jetojnë në bashkësi faktike apo ndërjegjësimit të atyre që futen në marrëdhënie në çift për ndryshimin në efektet e këtyre marrëdhënieve familjare.

5. Bashkëshortet trashëgojnë si trashëgimtarë të rradhës së parë, megjithatë në ligj nuk parashikohen specifikime mbi rrethana që lidhen me situatën ekonomike të bashkëshortëve pasjetues, e më konkretisht grave duke ju lënë të drejtën të trashëgojnë njësoj si në rastin kur gruaja është e aftë, ashtu edhe në rastin kur është e paaftë për punë apo përballet me pengesa të tjera.

6. Rritjen e vigjilencës profesionale në fazën e hartimit të Deklaratës së Trashëgimisë, bazuar në Aktevedkjen e cila bazuar në nenin 134 të Ligjit Nr. 03/L-007 Për Procedurën Jokontestimore aktvdekja hartohet në bazë të të dhënave që janë marrë nga kushërinjtë e personit të vdekur, nga personat me të cilët ka bashkëjetuar i vdekuri, si dhe nga personat e tjerë që mund të japin të dhëna që shënohen në aktvdekjen. Ky parashikim ligjor ka krijuar hapesirë për shmangie të trashëgimtareve femra, megjithë parashikimin e së drejtës së ankimit si garanci ligjore.

7. Femrat ruajnë të drejtën për të hequr dorë nga trashëgimia. Nisur edhe nga modele të tjera ligjore në rajon, ekziston mundësia që koheqzgjatja e ushritit të së drejtës të jetë më e shkurtur duke zvogeluar shanset për presion në familje apo rrethana të tjera, që e cojnë trashëgimtarin të heqë dorë.

Në këtë drejtim është ezigjencë e kohës ngritja e vetëdijes së grave se heqja dorë nga trashëgimia i çon në privim nga të drejta pasurore dhe varësia ekonomike, në të cilën vendosen duke ngushtuar edhe hapësirën e shumë të drejtave të tjera në familje dhe shoqëri.

8. Përfitimi prej mekanizmit të heqjes dorë nga e drejta për të trashëguar del nga konteksti për të cilin është parashikuar është kthyer në të mundësi "me cen".

9. Shprehja e vullnetit për heqjen dorë nga trashëgimia në formën e deklaratës nevojitet të verifikohet zyrtarisht në gjykatë. Për këtë rekomandohet këmbnulpja

dhe angazhimi i lartë gjyqtarëve në verifikimin e vullnetit të trashëgimtares nga njëra anë dhe organizimi i aktiviteteve trajnuese për gjyqtarët nga Këshilli gjyqësor apo institucionet e linjës me qëllim ndërfitjen e metodave më të mira të praktikës profesionale në këtë drejtim.

10. Ekzistenca e mundësisë së parashikuar në ligj që, lejon prindërit që të heqin dorë nga e drejta e trashëgimisë së pasardhësve të mitur, pa miratim nga organi i kujdestarisë. Nisur nga parimi i sigurisë juridike kryerja e veprimeve të administrimit jo të zakonshëm (veprime juridike, të cilat mund të ndryshojnë fatin e pasursë së fëmijës) të pasurisë së fëmijës nuk mund të bëhet vetëm me autorizimin apo lejen paraprake të Organit kompetent të Kujdestarisë. Nën kontekstin e mendësisë që rezulton në shoqëri dhe diferencimeve gjinore që bëjnë prindërit e synimin që pasuria duhet të ngelet në familje, kjo do të mundësonte lehtësisht shmangien nga trashëgimia të vajzave të mitura, megjithëse kjo e drejtë u buron parimisht nga ligji. Në kushtet e kontraditave ligjore midis kësaj norme dhe dispozitave për administrimin e pasurisë së fëmijës, paraqitet e nevojshme heqja e kësaj të drejte për prindërit.

11. Gratë nuk kanë njohuri për statistika zyrtare mbi efikasitetin e gjyqësorit sa i përket shqyrtimit të lëndëve të trashëgimisë pronësore nga gratë. Natyrshëm, nëse gratë të ishin të informuara për nivelin e çështjeve të përfunduara në favor të të drejtës së tyre do të rritej edhe numri i grave, të cilat do të dëshironin që këtë të drejtë në pamundësi për ta realizuar sipas zakonisht, ta realizojnë me Ligjin civil. Prandaj, besojmë se këto vendime gjyqësore të cilat janë në favor të grave duhet të promovohen dhe të jenë transparente nga organet pushtetit gjyqësor dhe aktorët e tjerë, që ndihmojnë publikimin e ketyre fakteve.

12. Reformat ligjore dhe politike nuk janë të mjaftueshme për gratë për të realizuar plotësisht të drejtat e tyre të posedojnë dhe përdorin pronën. Pajtimi midis normave zakonore dhe ligjet e vendit kërkojnë ndryshime në nivel lokal.

13. Rritja e kapaciteteve të jursiteve dhe zyrtareve me qëllim eliminimin e zbatimit të praktikave të dyfishta, keqinterpretimeve të ligjeve dhe uljen e nivelit të burokracisë në përbushjen e detyrimeve të tyre. Për gratë kjo do të përkthehej në rritje të besimit se do të përfitojnë të drejtat që u takojnë dhe rritjen e rasteve kur gratë pretendojnë realizimin e ketyre të drejtave pronësore.

14. Rishqyrtimi i çështjeve nga Gjykatat dhe hapja e një kalvari të gjatë seancash na jep arsye të përkufizojmë demoralizimin e grave në shoqëri për të pretenduar të drejtën e tyre. Në kushtet e nismave reformuese, mbështetjes së shprehur publikisht prej organeve të pushtetit ekzekutiv në vend dhe ndihmës së ofruar nga aktorë të ndryshëm që veprojnë në Kosovë, fokusi duhet të jetë

edhe në kontrollin e veprimtarisë së Gjykatave dhe organeve që mbështesin mbledhjen e provave në një proceset e trashëgimisë.

PUNIMET E CITUARA

1. Benschop, Marjolein (22 April 2004), "Women's rights to land and property", in UN-HABITAT, Women in human settlements development - challenges and opportunities, New York: Commission on Sustainable Development
2. The World's Women reports - World's Women 2000: Chapter 5 - Work". United Nations Statistics Division. Retrieved 6 June 2014.
3. Roccia, M. (2015) 'Reforming Property Law in Kosovo: A Clash of Legal Orders', European Review, DOI: 10.1017/S1062798715000307.
4. Voirin, Pierre dhe Goubeaux, Gilles: Droit civil, droit privé notarial, régimes matrimoniaux, successions-libéralités
5. Aliu, Abdullah, E Drejta sendore (pronësia), Prishtinë 2006
6. Beignier Bernard dhe Do Carmo Silva, Jean-Michel: Liquidations des régimes matrimoniaux et de successions
7. Raporti i BIRN për të Drejtën e Grave për Trashëgim në Pronë, Korrik 2016
8. Sonila Omari, E drejta familjare, Botimet Morava, Tiranë 2010
9. E. Farruku "Il Kanun, L'onore degli albanesi tra passato e presente . Annalisi di uno fenomeno culturale ". Rivista Giuridica Stato e Chiesa, Roma, 2011.
10. Salvatore Villari, "Le Consuetudini giuridiche dell'Albania: Il kanun di Lek Dukagjin, Societa editrice del libro italiano, 1940
11. Rustem Gjata, Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe rëndësia e tij në shoqërinë shqiptare
12. Aleks Luarasi, "Marrëdhëniet Familjare", SHB Luarasi, Tiranë 2001 Policy makers guide to women's land, property and housing rights across the world, UN Habitat 2007¹ Đurđa Knežević, Are Good Laws Enough? The Situation of Women in Croatia, 2013
13. Groen, Caren; Gupta, Geeta Rao; Kes, Aslihan, Taking action achieving gender equality and empowering women (Task Force on Education and Gender Equality)., ISBN 1844072223 London Sterling (2005).
14. Qendra për nisma ligjore qytetare, Të drejtat pronësore dhe gruaja, Broshurë informuese, Tiranë, 2014, fq.11
15. Brochure on Women's Property Rights in Kosovo "Do Not Remain Silent", IGJK dhe UN Women, Prishtinë 2013

16. Buffalo Women's Law Journal, International Column: The Legal Status of Women in Croatia: A Report on the Activities of Legaline, A Telephone Service Providing Legal Advice to Women
17. Florence Chagadama, A Critical Examination Of The Use Of Mediation As A Tool For The Realisation Of Women's Access To Justice In Property Cases In The Legal Aid Sector, Zimbabwe, 2014
18. E Drejta e Trashëgimisë Pronësore të Grave në Kosovë, botuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Prishtinë 2011
19. Nuni, Ardian dhe Hasneziri, Luan: E drejta civile III (trashëgimia)
20. Kushtetuta e Republikës së Kosovës
21. Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore
22. Ligji për familjen i Kosovës
23. Ligji për trashëgiminë
24. Ligji për procedurën kontestimore
25. Ligji për procedurën jokontestimore
26. Kodi civil i Republikës së Shqipërisë
27. Ligji i familjes së Republikës së Kroacisë